



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government






*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

RAPORTI VJETOR

I AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

2023



Prishtinë, 2023

RAPORTI VJETOR

I AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

2023

Prishtinë, 2023

PËRMBAJTJA

1	FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	FAQE 06
----------	--	----------------

2	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	FAQE 12
2.1	Mandati dhe përgjegjësitë	12
2.2	Struktura organizative	12

3	AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE	FAQE 16
3.1	Projektligji NR.08/L-237 për Kadastër të Pronave të Paluajshme dhe Udhëzimet Administrative	16
3.2	Ligji Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës	18
3.3	Udhëzimet Administrative për zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës	20
3.4	Strategjia e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH)	21
3.5	Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimeve Administrative për kadastër	22
3.6	Projekt Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës	23

4	NGRITJA E NIVELIT TË BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET PUBLIKE	FAQE 26
4.1	Vizita e Kryeministrit të Republikës së Kosovës	26
4.2	Vizitat e Ministrisë të MMPHI-së	27
4.3	Vizita e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës	29
4.4	Komiteti Ndërmintor për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës	30
4.5	Rregullorja e Punës së Komitetit për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës	33
4.6	Takimi koordinues ndërinstitucional me Kryetarët e të gjitha Komunave të Republikës së Kosovës	34
4.7	Takimet koordinuese me donatorë	35
4.8	Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione Publike	36
4.9	Funksionalizimi i zyreve kadastrale komunale në komunat veriore	37

5	PROJEKTET KAPITALE	FAQE 42
5.1	Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës	42
5.2	Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive	43
5.3	Avancimi i sistemeve kadastrale	45
5.4	Korrektimi/përmirësimi i të dhënave në SIKTK-T	48
5.5	Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së	49
5.6	Furnizimi me pajisje gjeodezike për matje	50
5.7	Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik	50
5.8	Zgjerimi i qendrës së të dhënave të AKK-së (Hardware+Software)	50
5.9	Sistemi i unifikuar i adresave	51

6 ZHVILLIMET / AVANCIMET NË SISTEME KADASTRALE FAQE 58

6.1 Kufizimi në regjistra kadastral për ruajtjen e radhës së aplikimit	58
6.2 Gjurmirimi i lëndëve që dorëzohen nga qytetarët në ZKK	59
6.3 Shënimi nga ana e Noterëve dhe Përmbauesve privat	60
6.4 Produktet kadastrale në e-Kosova: Certifikatat e pronësisë, Kopjet e planit dhe Koordinatat e njësive kadastrale tani edhe Online	60
6.5 Digjitalizimi i regjistrimit të barrës tatimore në Regjistrin e të drejtave pronësore	62
6.6 Vërtetimi i tatimit në pronë nuk duhet dorëzuar si dëshmi në ZKK për të marrë shërbime kadastrale	63
6.7 Shkurtohet lista e dokumenteve për dorëzim në ZKK	63

7 NGRITJA E KUALITETIT TË TË DHËNAVE FAQE 66

7.1 Korigjimi/unifikimi i personave të regjistruar dy e më tepër herë në SIKTK me të njëjtin numër personal	66
7.2 Fshirja e hipotekave të skaduara	63
7.3 Unifikimi i emërtimeve të personave juridik	65

8 KOORDINIMI I PROJEKTEVE FAQE 72

8.1 Projekti për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeo-Hapësinore (REGIP)	72
8.2 Bashkëpunimi me USAID	80
8.3 Bashkëpunimi me GIZ-in	82
8.4 Mbështetja e Qeverisë Holandeze — Projekti Spatial II për Ballkanin Perëndimor	82
8.5 Bashkëpunimi me UN HABITAT-in	83
8.6 Bashkëpunimi me OSBE-në	83

9 ADMINISTRIMI INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI) FAQE 86

9.1 Mirëmbajtja e dhomës së serverëve	86
9.2 Aktivitete rreth sigurisë	86
9.3 Monitorimi	89
9.4 Testimi i ngritjes së shërbimeve në DRC	90
9.5 Administrimi i Sistemeve të Informacionit (SI), databazave dhe qasjeve	90

10 SHËRBIMET DHE OFRIMI I TË DHËNAVE FAQE 92

10.1 Shpronësimi	92
10.2 Statistika nga SIKTK	95
10.3 Statistika nga shkëmbimi i të dhënave me institucionet e jashtme	98
10.4 Statistika nga DL	99
10.5 Statistika nga Sistemi i Pozicionimit Satelitor në Kosovë — KOPOS	100
10.6 Statistika nga Drejtoria e Financave dhe Shërbimet e Përgjithëshme — produktet e AKK-së	101

11 BUXHET DHE FINANCA FAQE 104

11.1 Kesh plani- Plani i rrjedhës së parasë	104
11.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2023 (pasqyrat financiare)	104
11.3 Korniza Afatmesme e Shpenzimeve - KASH 2023-2025	104
11.4 Pyetësori Vetëvlerësues i komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Regjistri i rrezikut	104
11.5 Planifikimi i buxhetit për vitin 2024, 2025 dhe 2026, Qarkorja I dhe II	105
11.6 Vlerësimi financiar	105
11.7 Lista me shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve zyrtare	105
11.8 Tjetërsimi i pasurisë	105
11.9 Buxheti	106
11.10 Të hyrat	108
11.11 Prokurimi publik	108

12 PJESËMARRJE NË KONFERENCA, PUNËTORI, GRUPE PUNUESE DHE VIZITA STUDIMORE FAQE 110

12.1 Vizitë në Arec në Maqedonisë Veriore	110
12.2 Pjesëmarrje në nakimin negjional të organizuar nga BB	110
12.3 Pjesëmarrje në punëtorinë e 4-të ndërkombëtare për kualitetin e të dhënave hapësinore	110
12.4 Punëtori AKK-USAID-ZKK Ferizaj në kuadër të komitetit të praktikave të mira	111
12.5 Punëtori për projektin "Zhvillimi i moduleve të reja në sikt"	111
12.6 Punëtori në bashkëpunim me USAID dhe komunën e Suharekës, Rahovecit dhe Lipjanit	112
12.7 Punëtori për IKIH	112
12.8 Pjesëmarrje në punëtorinë për komasacion e organizuar nga AKP	113
12.9 Pjesëmarrje në punëtorinë për shpronësim e organizuar nga MMPhi	113
12.10 Punëtori dy ditore AKK, USAID, ZKK gjilan në kuadër të aktivitetit qeverisja e pronës	114
12.11 Pjesëmarrje në aktivitetet për transformim digjital dhe eQeverisje	115

13 TRAJNIMET E OFRUARA FAQE 118

13.1. Trajnimet e stafit të ZKK-ve	118
13.2. Trajnimet e Gjeodetëve	118
13.3. Trajnimi i stafit të angazhuar për përditësimin e adresave	118
13.4. Trajnimet e shfrytëzuesve të SIKTK-së nga institucionet tjera	118
13.4.1 Trajnimi i Noterëve	118
13.4.2 Trajnimi i Përmbauesve privat	119
Trajnime në të cilat ka marr pjesë stafi i AKK-së:	119

14 LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE FAQE 122

15 MONITORIMI I ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE TË LICENCUARA GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENUAR FAQE 124

15.1 Monitorimi i ZKK-ve	124
15.2 Monitorimi i Kompanive të licencuara gjeodete dhe Gjeodetëve të licenuar	125

16 MARRËDHËNIE ME PUBLIK DHE GJITHËPËRFSHIRJE

FAQE 128

16.1 Ueb faqja zyrtare e AKK-së	128
16.2 Facebook	128
16.3 Gazeta periodike "KADASTRA"	129
16.4 Gjeoportali Shtetëror	130
16.5 Barazia gjinore	130
16.6 Qasja në dokumente publike	131

17 KALENDARI ME NGJARJE TË RËNDËSISHME

FAQE 134

17.1 (12 Janar) Takimi me Zyrarët e Urbanizmit për Projektin e Adresave	134
17.2 (10 Shkurt) Digjitalizimi i regjistrimit të barrës tatimore	134
17.3 (20 Mars) Koordinimi i aktiviteteve të planit kombëtar zhvillimor	134
17.4 (30 Mars) AKK përshpejton regjistrimin e pronave në emër të Republikës së Kosovës	135
17.5 (5 Prill) Takim koordinues në mes të AKK-së dhe USAID-it	135
17.7 (20 Prill) Takim me Odën e Përmbaruesve Privat të Kosovës	136
17.6 (7 Prill) Takim me N.H. "IBER LEPENC"	136
17.8 (27 Prill) Takim me USAID-in për Qeverisje Ekonomike	137
17.9 (5 Maj) Takim me AKKVP dhe OSCE	137
17.10 (15 Maj) Takim Koordinues Mes AKK-së, APK-së, AKP-së dhe Ministrisë së Bujqësisë	138
17.11 (26 Maj) Takimi i komitetit të praktikave të mira	138
17.12 (31 Maj) Takim me përfaqësuesit e zyrës japoneze për bashkëpunim - JICA	139
17.13 (2 Qershor) Përfaqësues të misionit të bankës botërore për projektin REGIP kanë vizituar AKK-në	139
17.14 (9 Qershor) Takim me Administratën Tatimore të Kosovës	140
17.15 (14 Qershor) Takim me Shoqatën e Gjeodetëve	140
17.16 (12 Korrik) Mbahet Testi për Licencim të Gjeodetëve në Republikën E Kosovës	141
17.17 (14 Korrik) Për herë të parë akk ka filluar monitorimin e drejtëpërdrejtë të punëve të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuar në vend	141
17.18 (26 Korrik) Takim me Ekspertët e Bankës Botërore	142
17.19 (9 Gusht) AKK shpërndan licencat për gjeodetë dhe kompani gjeodete	142
17.20 (15 Gusht) Takim me KFOR-in Britanik	143
17.21 (13 Shtator) AKK monitoron në terren aktivitetet në kuadër të projektit rievimi Aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës	143
17.22 (20 Shtator) Takimi i rradhës i komitetit të praktikave të mira	144
17.23 (29 Shtator) Takim me përfaqësuesit E GIZ-it Gjerman	144
17.24 (18 Tetor) Vizita e Misionit të Bankës Botërore në AKK	145
17.25 (25 Tetor) Takimi i dytë koordinues mes AKK-së, AKP-së dhe Ministrisë së Bujqësisë	145
17.26 (28 Shtator) Projekti për matjen e rrugëve të reja në teren	146
17.27 (19 Tetor) Komisioni për mjedis, ushqim, bujqësi, planifikim dhe zhvillim aprovon projektligjin për kadashtë të pronës së paluajtshme	146
17.28 (25 Tetor) AKK vizitë në ZKK Shtërpçë	147
17.29 (30 Tetor) Takim me agjencinë për parandalimin e korrupsionit	148
17.30 (2 Nëntor) AKK fillon dorëzimin e raporteve të monitorimit tek kryetarët e komunave dhe drejtorët e ZKK-ve	149
17.31 (8 Nëntor) Takim me përfaqësuesit e projektit PIAKOS	149
17.32 (10 Nëntor) Dorëzimin e raporteve të monitorimit tek zyrtarët e komunës së Shtëmës	150
17.33 (14 Nëntor) Takim me kryetarët e Komunave Veriore	150
17.34 (5 Dhjetor) AKK pret në takim ekspertë të bankës botërore në kuadër të projektit "Rritja e Cilësisë dhe Fushëveprimi të Regjistrimit të Tatimpaguesve"	152
17.35 (7 Dhjetor) AKK pret në takim përfaqësues nga shoqata e Bankave të Kosovës	153

18 PLANI I PUNËS PËR VITIN 2024 - REFORMAT DHE PROJEKTET

FAQE 156

SHKURTESAT

- **AKK** - Agjencia Kadastrale e Kosovës
- **IKIH**- Infrastruktura Kombëtare e Informacioneve Hapësinore
- **ZKK** — Zyrat Kadastrale Komunale
- **MMPHI** — Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- **RK** - Rindërtimi i Kadastrit
- **UA** - Udhëzimet Administrative
- **DRC**—Qendra për Rimëkëmbje për Rast Fatkeqësish, Ang. Disaster Recovery Center
- **DTM** — Modeli Digjital i Terrenit, Ang. Digital Terrain Model
- **DSM** — Modeli Digjital i Sipërfaqeve, Ang. Digital Surface Model
- **DEM**— Modeli Digjital i Lartësive, Ang Digital Elevation Model
- **SOA** — Arkitekturë e Orientuar në Shërbime, Ang. Services Oriented Architecture
- **SIKTK** — Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë
- **SIKTK-HK** — Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë —Harta Kadastrale
- **SIKTK-T** — Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë Tekstuale
- **ARIS**- Sistemi i Informacioneve për Regjistrin e Adresave
- **SUUSHK** - Sistemi i Unifikuar i Ueb Shërbimeve Kadastrale
- **KOKOS** — Sistemi i Pozicionimit Satelitorë në Kosovë
- **AKKPVP** - Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
- **GG** - Platforma e Interoperabilitetit, Ang. Government Gateway
- **ZQP** — Zona e Qarkullimit Publik
- **REGIP**—Projekti për Regjistrimin e Pronës dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore, Ang. Real Estate Cadastre & Geospatial Infrastructure
- **PI/GG** - Platforma e Interoperabilitetit, Government Gateway
- **GIS** — Sistemi i Informacioneve Gjeografike
- **ASHI** - Agjencia për Shoqëri të Informacionit

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm



Të nderuar/a,

Agjencia Kadastrale e Kosoves (AKK), po e përmbyll një vit tejet të suksesshëm të punës dhe aktiviteteve të saj.

Viti 2023, do të mbetet në histori te Agjencisë, për shkak se po fillon një etapë e re për kadastrin në vend, meqenëse këtë vit Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme.

Reformat në legjislacion janë vazhdimësi e punës disa vjeçare që kanë filluar qysh nga viti 2018, të cilat rezultuan me aprovimin e Ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, aprovimin e 5 Udhëzimeve Administrative për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH), plotësim/ndryshimin e dy Udhëzimeve Administrative të

kadastrit, përgatitjen e drafteve për 10 Udhëzime Administrative për implementimin e Ligjit për kadastër, si dhe përgatitjen e Strategjisë për IKIH.

Prej momentit që kam marrë udhëheqjen e AKK-së, bashkë me profesionistë e bashkëpunëtorë të Agjencisë, por edhe me bashkëpunëtorë nga institucionet e tjera, kemi punuar maksimalisht, në veçanti për rikthimin e dinamikës së punës në realizimin e objektivave tona. Ka qenë tepër sfiduese këtë vit, që të rikthejmë dinamikën e punës në aktivitetet e Projektit REGIP të Bankës Botërore, pasi që përqindja e realizimit të punëve ka qenë shumë e ulët.

Megjithatë, me këmbëngulje dhe përkushtim të pa kompromis kemi arritur që të shënojmë një ndryshim të fuqishëm në trajektorën e suksesit të Agjencisë. Me një strategji të fokusuar dhe ambicioze, duke vendosur standarde të reja të punës dhe duke lënë shenja të pashlyeshme në trashëgiminë e saj, me një vizion të guximshëm për rivitalizimin e Agjencisë në dobi të të gjithë qytetarëve, sot Agjencia Kadastrale e Kosovës, numron shumë suksese dhe ka rritje të vazhdueshme e të pa precedent.

Këtë vit, kemi nisur implementimin e projekteve kapitale, përfshirë aerofotografimin, rrjetin e nivelimit, matjen dhe përditësimin e të dhënave në sistemin e adresave, duke përgatitur gjithashtu specifikat teknike dhe termat e referencës për shumë projekte të tjera, të cilat planifikohet të nisin realizimin e tyre gjatë gjysmës së parë të vitit 2024.

Mbështetja dhe përkrahja ndërinstitucionale, duke përfshirë edhe instancat më të larta institucionale shtetërore, janë manifestuar me mbështetje konkrete edhe me vizita nga krerët e shtetit. Këtë vit, për herë të parë që nga themelimi i AKK-së, një vizitë domethënëse u bë nga Kryeministri Z. Albin Kurti. Në këtë takim, Kryeministri premtoi mbështetje të vazhdueshme për AKK-në, me fokus në implementimin e Ligjit për kadastër të paluajtshmërive, zhvillimin e projekteve të Bankës Botërore, funksionalizimin e Zyreve Kadastrale Komunale në Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, si dhe aktivitetet e tjera të realizuara me sukses nga AKK-ja në muajt e fundit.

Në vitin aktual, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka vazhduar serinë e takimeve periodike dhe ka gëzuar përkrahjen nga Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Z. Liburn Aliu. Përmes këtyre takimeve kemi shënuar një bashkëpunim të thellë e të ndërsjellë, në angazhimin e plotë të Ministrisë dhe Agjencisë për transformimin dhe fuqizimin e kadastrës në vend.

Një sukses tjetër i këtij viti është koordinimi i një sesion takimi ndërinstucional me kryetarët e të gjitha komunave të Kosovës, me synim informimin e tyre në lidhje me projektet e planifikuara nga AKK, duke theksuar partneritetin dhe bashkëpunimin thelbësor me komunat.

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/94, datë 24.08.2022, është themeluar Komiteti për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, AKK ka organizuar dy sesione takimesh të këtij komiteti, në muajin Qershor dhe Tetor.

Në vitin 2023, janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e USAID-it, UN HABITAT-it, GIZ-it, JICA-s, ekspertët e Bankës Botërore dhe Kadastrin Holandez, me qëllim të koordinimit të veprimtarive.

Funksionalizimi i Zyrave Kadastrale Komunale në katër Komunat Veriore shënon një sukses institucional, duke transferuar përgjegjësitë kadastrale drejt komunave për qytetarët e tyre.

Me qëllim të avancimit të digjitalizimit të shërbimeve dhe lehtësimit të procedurave administrative për qytetarët, AKK ka ndërmarrë një sërë inovacionesh gjatë këtij viti, si kufizimi në regjistrat kadastral për ruajtjen e radhës së aplikimit dhe ruajtjen e rregullsisë së aplikimeve, mundësia për gjurmimin e lëndës nga qytetarët 24/7, përcaktimi i shënimit nga Noterët dhe Përmbauesit privat, si dhe regjistrimi i barrës tatimore në formë digjitale, përbëjnë vetëm disa nga aspektet thelbësore të përmirësimeve të ndërmarra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Në kontekstin e thjeshtësimit të procedurave, vlerësohet shfuqizimi i Rregullores (QRK) Nr. 07/2021 për Pezullimin e Shërbimeve Komunale në lidhje me Detyrimet e Papaguara të Tatimit në Pronë, duke eliminuar nevojën për vërtetim të pagesës së tatimit në pronë për të gjitha shërbimet kadastrale.

Përveç kësaj, e për më shumë, vitin 2023 e ka karakterizuar monitorimi i performancës së disa Zyrave Kadastrale Komunale, Kompanive të Licencuara Gjeodete dhe Gjeodetëve të Licencuar.

Si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm për të garantuar cilësi dhe saktësi të të dhënave kadastrale, AKK ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, përfshirë korrigjimin/unifikimin e personave të regjistruar dy ose më shumë herë në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë me të njëjtin numër personal, unifikimin e emërtimeve të personave juridik, si dhe eliminimin e hipotekave të skaduara.

Për të siguruar kushte më të mira pune, ambiente moderne dhe me pajisje e teknologji bashkëkohore këtë vit ka filluar ndërtimi i objektit të ri të AKK-së, i cili pritet të përfundohet mbrenda dy viteve.

Pavarësisht sfidave të një viti të ngarkuar me punë siç ka qenë viti 2023, pritet që viti 2024 të sjellë një sërë aktivitete të tjera, duke përfshirë obligimet e reja që dalin nga Ligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme. Në këtë kornizë, AKK shpreh zotimin për përdorimin maksimal të kapacitetit dhe potencialit të saj, duke synuar implementimin e këtij ligji me qëllim të avancimit të performancës, përgjegjësisë së theksuar, si dhe përmirësimit të bashkëpunimit dhe koordinimit, për të siguruar shërbime kadastrale të shkëlqyera për qytetarët e vendit.

“Sfida e përgjegjësi të reja na presin edhe në vitin 2024, por duke besuar në përpjekjet dhe angazhimin tonë maksimal përfshirë edhe bashkëpunimin e plotë me të gjitha palët e interesit, është e pamohueshme që rezultatet dhe sukseset e punës së AKK-së për vitin që po hyjmë padyshim se do të jenë një kryevepër”.

Avni AHMETI

Zv. Drejtor i Përgjithshëm



2

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2.1 Mandati dhe përgjegjësitë

Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron si Agjenci Ekzekutive në kuadër të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, hartografi dhe GIS, sistemin e unifikuar të adresave, infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.

Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve dhe kornizave të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, është përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale për operim në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës (SIKTK) dhe për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete për ofrimin e shërbimeve kadastrale. Duke u bazuar në ligjin në fuqi AKK, ka deleguar tek Zyrat Komunale Kadastrale detyrat për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave në SIKTK sipas legjislacionit në fuqi, të cilat ofrojnë shërbime për person fizik dhe juridik, si dhe për institucionet publike tashmë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Të drejtat, përgjegjësitë dhe në përgjithësi mandati i AKK-së është i rregulluar me Ligjin për Kadastër dhe me akte të tjera nënligjore, të gjitha të qasshme përmes linkut <https://akk.rks-gov.net/sq/dokumente/legjislacioni>.

2.2 Struktura organizative

AKK në strukturën e saj organizative ka 5 Drejtorit dhe 14 Sektorë, respektivisht: Drejtorati i Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme, i Gjeoinformacionit, i Menaxhimit të Sistemit të Teknologjisë së Informacionit, Ligjor dhe për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme. Numri i të punësuarve të aprovuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2023 është 52 punëtorë. Të aprovuar janë 52 dhe aktual janë 46, prej tyre 31 meshkuj dhe 15 femra.


Mosha mesatare është 43 vjet. Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë të punësuar edhe 16 zyrtarë si staf mbështetës të cilët janë të financuar nga donatorët - Banka Botërore, prej tyre 9 meshkuj dhe 7 femra.

Me 05.01.2023 ka hyri në fuqi Ligji Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik dhe nga muaji shkurt 2023 ka filluar zbatimi i ligjit për paga me ç'rast në Agjencinë Kadastrale janë aprovuar si:


Emërtimi i pozitës	Pozita	Klasa	Koeficienti	Nr. i pozitave
Drejtuës i lartë	Drejtor i Përgjithshëm	I 2	12	1
Drejtuës i mesëm	Drejtor i Departamentit	I 8	8.3	3
Drejtuës i ulët	Udhëheqës i Divizionit	I 10	7.35	7
Specialist	Ekspert i GIS/it	I 11	7	5
Profesional 1	Zyrtar i Lartë	I 13	5.7	7
Profesional 2	Zyrtar	I 15	5.1	7
Profesional 3	Zyrtar	I 17	4	6
Nëpunës teknik dhe mbështetës	Vozitës	I 21	3.86	3

Lista e ekspertëve e aprovuar nga Qeveria me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023 si:


Zyrtari	Emri i pozitës	Klasa	Koeficienti	Nr. i pozitave të propozuara
Ekspert 2	Drejtor i Drejtoratit për Teknologji të Informacionit	B2,	15.5	1
Ekspert 4	Administrator i Lartë i TI-së për siguri	B4,	14	2
Ekspert 4	Zhvillues/administrator i lartë i bazës së të dhënave	B4,	14	1
Ekspert 5	Administrator i Lartë i TI-së për Baza të Dhënave	B5,	12	1
Ekspert 5	Administrator i Lartë e TI-së për Sisteme Softuerike	B5,	12	1
Ekspert 5	Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme	B5,	12	1



Profili i moshës së nëpunësve



Gjinia e nëpunësve



Përkatësia etnike e nëpunësve

3

AVANCIMI I
KORNIZËS LIGJORE

3. AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

Në kuadër të reformave të parapara në kadastër dhe për tu ballafaquar me kërkesat në rritje të qytetarëve dhe institucioneve për produkte dhe shërbime sa më kualitative, sa më të sigurt dhe në kohë sa më të shpejtë, AKK-ja vitet e fundit ka ndërmarrë iniciativën për avancimin e kornizës ligjore. Përveç përgatitjes dhe aprovimit të Ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës dhe 5 Udhëzimeve Administrative që mbështesin këtë ligj, këtë vit është aprovuar edhe Ligji për Kadastër të Pronave të Paluajtshme dhe janë përgatitur draft Udhëzimet Administrative që derivojnë nga ky ligj.

3.1 Ligji NR.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe Udhëzimet Administrative

Në Programin Legjislativ për vitin 2023, është propozuar hartimi i Projektligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, i cili është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 145-të të mbajtur me datë 7 qershor 2023. Rregullimi normativ i projektligjit ka rëndësi të veçantë për sektorin e të drejtave pronësore, pasi që përcakton kriteret dhe institucionin përgjegjës për mbajtjen, ruajtjen, dhe përditësimin e regjistrave shtetëror të pronave të paluajtshme si dhe të drejtave pronësore mbi ato prona.

Me Projektligjin për Kadastër janë definuar shumë çështje, përfshirë integrimin e dispozitave të dy ligjeve ekzistuese (Ligji Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe Ligji Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrat të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme) dhe organizimin vertikal duke bashkuar AKK-në dhe 38 ZKK-të në një institucion të integruar, me një strukturë vertikale të menaxhimit.

Në aspektin profesional ky projektligj rregullon tri elemente themelore të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm dhe avancimin e fushës së kadastrit në veçanti dhe proklamimin e të drejtave pronësore në përgjithësi.

Projektligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin e kadastrit përfshirë organizimin institucional të kadastrit në Republikën e Kosovës,

përmbajtën e kadastrit, matjet kadastrale, regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe të drejtave pronësore mbi ato prona në kadastër, rindërtimin e kadastrit etj.

Elementet themelore që ky projektligj i trajton dhe rregullon janë:

- Procedura e unifikuar administrative në ZKK, pasi që aktualisht ekzistojnë dy ligje (Ligjin Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe Ligjin me Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrat të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme), ndërsa me këtë projektligj, do të kemi një procedurë unike dhe të integruar në një sistem,
- Organizimi vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrave Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me qëllim të rritjes së performancës, përgjegjësisë në punë, bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë, duke u bazuar në sistemin kadastral të shteteve të rajonit dhe më gjerë dhe
- Trajtimi i problemit më të theksuar në të drejtat pronësore që është informaliteti i lartë, prandaj formalizimi i të drejtave pronësore është synim parësor në sektorin e të drejtave pronësore pasi që të drejtat pronësore të pa formalizuara janë jashtë qarkullimit juridik, e cila do të realizohet përmes fuqizimit të rolit të komisionit për Rindërtimin e kadastrit.

Projektligji nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, është miratuar në parim në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 08-V-581 të datës 13.07.2023.

Ky projektligj pastaj është shqyrtuar nen për nen në Komisionin për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, i cili ka paraqitur raportin me amendamente për komisionet e përherëshme për shqyrtim dhe aprovim.

Projektligji është aprovuar në Kuvend edhe në lexim të dytë me dt. 14.12.2023 dhe pas dekretimit nga Presidentja do të shpalljet në Gazetë Zyrtare dhe do të fillohet me zbatimin e tij.

Paralelisht me shqyrtimin e këtij projektligj në Kuvendin e Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka filluar me hartimin e drafteve të 14 udhëzimeve administrative të cilat dalin nga ky projektligj. Me qëllim të përmbushjes së këtij procesi është formuar grupi i brendshëm punues për përgatitjen e drafteve fillestare, dhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdohet me procedurat e parapara ligjore për finalizimin e këtyre udhëzimeve administrative.

3.2 Ligji Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës

Politikat për mjedisin duhet të synojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e situatave në fusha të ndryshme.

Për më tepër, informacioni hapësinor është i nevojshëm për hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave, të cilat duhet të integrojnë kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Në mënyrë që të arrihet një integrim i tillë, është e domosdoshme të krijohen mekanizmat e koordinimit në mes të përdoruesit dhe ofruesit të informacionit, në mënyrë që të dhënat dhe njohuritë nga sektorët e ndryshëm të mund të kombinohen. Në këtë infrastrukturë do të jenë të gjitha të dhënat e grumbulluara nga të gjitha institucionet e veçanta në mënyrë që të përdoren më lehtë nga të gjitha palët.

Kjo është arritur duke përcaktuar përgjegjësitë e të gjitha institucioneve përgjegjëse të Republikës së Kosovës, ndërsa bashkërendimin sipas këtij ligji do ta bëjë AKK. Me këtë Ligj janë përcaktuar rregullat e përgjithshme për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës, për jetësim të politikave hapësinore, mjedisore dhe aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim në to.

Me këtë Ligj:

- Mundësohet krijimi, mbledhja, si dhe shkëmbimi i informacioneve hapësinore me vendet tjera, sipas praktikave të Bashkimit Evropian;
- Bëhet përcaktimi i qartë i përgjegjësive të strukturave qeverisëse të Kosovës, si dhe i kompetencave për krijimin, grumbullim dhe shkëmbim të informacioneve hapësinore në Republikën e Kosovës;
- Krijohet mundësia për përcaktim të qartë të kriterëve për krijimin e informacioneve dhe meta të dhënave si pjesë e infrastrukturës kombëtare të të dhënave hapësinore për Republikën e Kosovës.

Të dhënat hapësinore janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për Republikën e Kosovës. Shumë institucione krijojnë të dhëna hapësinore në lëmi të ndryshme për të cilat janë kompetente dhe përgjegjëse. Këto të dhëna hapësinore krijohen nga sfera e planifikimit hapësinor, banimit, bujqësisë, pylltarisë, kadastrit, minierave, infrastrukturës, statistikave dhe fushave tjera të administrimit të tokës.

Të dhënat përgatiten në formate të ndryshme që shpesh ka vështirësi në këmbimin dhe përdorimin e tyre nga institucionet e ndryshme të Kosovës por edhe atyre ndërkombëtare që punojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës.

Prandaj, është shumë e domosdoshme që të dhënat që krijohen nga institucionet e ndryshme të sistemohen në një bazë të të dhënave (Gjeoportali për IKIH) që do ta përbëjnë Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore për Republikën e Kosovës, e cila do të mirëmbahet nga AKK.

Objektivi kryesor i ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës është përcaktimi i qartë i përgjegjësive dhe kompetencave të institucioneve të Republikës së Kosovës që merren me krijimin e të dhënave hapësinore dhe përcaktimi i kriterëve për krijimin e të dhënave që do të jenë pjesë e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor për Republikën e Kosovës.

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, autoritetet përgjegjëse për koordinim të infrastrukturës së informacionit hapësinorë janë Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), Komiteti për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) dhe Institucionet e Administratës Publike që përgatisin dhe shfrytëzojnë informacionet hapësinore.


Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe angazhimi i përbashkët në koordinimin e aktiviteteve të këtij Komiteti do të mundësojë arritjen e objektivave drejt administrimit të qëndrueshëm të tokës dhe informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës. Angazhimi aktiv do të sigurojë bashkërendim të punës dhe aktiviteteve, drejt realizimit të nismave të rëndësishme që ndërlidhen me informacionin hapësinor në sektorin publik dhe privat. E gjithë kjo do të mundësojë arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, për përafrim të legjislacionit e praktikave shtetërore në linjë me standardet Evropiane.

3.3 Udhëzimet Administrative për zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës

Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, janë:

- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr 10/2023 për përbërjen, fushëveprimin dhe mënyrën e funksionimit të grupeve të punës;
- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr 11/2023 për përcaktimin e rregullave për shkëmbimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike;
- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 12/2023 për përcaktimin standardeve teknike për ofrimin e shërbimeve nga gjeoportali i IKIH-së;
- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 13/2023 për përcaktimin e standardeve për krijimin, ruajtjen, përditësimin dhe strukturën e meta të dhënave; dhe
- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 14/2023 për përcaktimin e rregullave të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë së burimeve të informacionit hapësinor.


Këto Udhëzime Administrative rregullojnë mënyrën e funksionimit të grupeve punuese për koordinimin e aktiviteteve në mes të autoriteteve përgjegjëse për IKIH, përcaktojnë rregullat për shkëmbimin e të dhënave hapësinore ndërmjet autoriteteve publike dhe kushtet e harmonizuara të qasjes në grupet dhe shërbimet e të dhënave hapësinore, përcaktojnë standardet teknike për ofrimin e shërbimeve nga gjeoportali i IKIH-së, përcaktojnë kërkesat dhe standardet për krijimin, ruajtjen, përditësimin dhe strukturën e meta të dhënave si dhe bëjnë përcaktimin e rregullave të hollësishme për realizimin e ndërveprueshmërisë së burimeve të informacioneve hapësinore.



Ligji Nr.08/L010 për IKIH dhe Udhëzimet Administrative për zbatimin e tij

3.4 Strategjia e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH)

Strategjia e parë për IKIH është zhvilluar disa vite më parë për periudhën pesëvjeçare 2015-2020, dhe tani nuk plotëson më të gjitha nevojat e palëve të interesit në fushën e IKIH-së. AKK, në kuadër të Projektit të Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), duke marrë huamarrje nga Banka Botërore, Konsulentit Individual, është angazhuar dhe ka hartuar Strategjinë e re për IKIH për periudhën pesë (5) vjeçare 2023-2028. Kjo Strategji do të ndihmojë në hapat përpara pas hyrjes në fuqi të Ligjit për IKIH.



Strategjia për zhvillimin e IKIH dhe shtojcat e saj

Me vendimin Nr. 7471/23, të datës 20.12.2023, nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së është formuar Ekipi Punues për Hartimin e Strategjisë Kombëtare të Informacionit Hapësinor sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Kjo Strategji pritet të aprovohet në Qeveri gjatë vitit 2024.

3.5 Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimeve Administrative për kadastër

Për vitin 2023, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka pas të planifikuara në Planin Legjislativ për aktet nënligjore, ndryshimin dhe plotësimin e dy Udhëzimeve Administrative që kanë të bëjnë me fushën e kadastrit, ato janë:

- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr.04/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 11/19 për ndarjen e ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës dhe
- Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr.05/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës.

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka të planifikuar projektin për korigjimin dhe plotësimin e të dhënave për person në Regjistrin e të dhënave kadastrale. Me qëllim të krijimit të bazës ligjore për të realizuar këtë projekt me rëndësi të madhe, Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2023 ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e dy udhëzimeve administrative. Përveç kësaj çështje me këto udhëzime administrative janë trajtuar edhe çështje tjera të cilat janë evidentuar gjatë zbatimit të udhëzimeve administrative të cilat janë në fuqi, duke përfshirë çështje teknike.

3.6 Projekt Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Projekt Rregullorja e re ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ku trajton organizimin e funksionimit të zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, të departamenteve dhe divizioneve.

Kjo iniciativë për Rregullore të re vjen si rezultat i:

- a) Dinamikës së re për të përmirësuar qasjen apo mënyrën e punës dhe
- b) Nevojave për t'ju përshtatur ndryshimeve të brendshme, si dhe obligimi që del pas hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, përkatësisht neni 12, i cili përcakton se: “Të gjitha Institucionet e Administratës Shtetërore, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara të hartojnë Rregulloret përkatëse për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në afat kohor prej gjashtë (6) muajsh dhe t'i paraqesin për miratim”.

Rishikimi i legjislacionit dhe politikave për kadastër përbën pjesën fillestare të procesit të rishikimit dhe riorganizimit të Agjencisë, që vjen si rrjedhojë e ndryshimit të legjislacionit sa i përket organizimit dhe funksionimit të Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe përcaktimit të Standardeve të Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura.



4

NGRITJA E NIVELIT TË
BASHKËPUNIMIT
ME INSTITUCIONET PUBLIKE

4.1 Vizita e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës, si institucion përgjegjës për administrimin e regjistrave pronësorë, hartografisë, kadastrit, gjeodezisë, sistemit të unifikuar të adresave dhe infrastrukturës kombëtare për informacione gjeohapësinore këtë vit shënoi një avancim të bashkëpunimit me institucione publike të vendit. Ndër takimet më të rëndësishme mund të përmendet ai me Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Albin Kurtin.

Kryeministri Kurti u njoftua nga afër me projektet, punët, aktivitetet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata që ka ky institucion për vitet në vazhdim.

Pas prezantimit të punës nga ana e drejtuesve të AKK-së, Kryeministri Kurti në fjalën e tij premtoi mbështetje për këtë institucion për Ligjin për kadastrë, aktivitetet e projektit të Bankës Botërore, funksionalizim e Zyreve Kadastrale Komunale në 3 Komunat Veriore, etj.

Vlen të theksohet që Agjencia Kadastrale e Kosovës për herë të parë vizitohet nga një Kryeministër dhe se kjo vizitë do të jetë mbështetje dhe motiv shtesë për punë në këtë institucion.




Momente nga vizita e Kryeministrit z. Albin Kurti në AKK

Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti bashkë me Ministrin e MMPHI-së, z. Liburn Aliu dhe zv. Drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, morën pjesë edhe në vendosjen e gurë-themelit të objektit të ri të AKK-së.

Agjencia Kadastrale e Kosovës e cila për momentin shfrytëzon objektin e Arkivës së Kosovës, pritet që shumë shpejt të bëhet me objekt të ri, me kushte më të mira për punë dhe hapësirë më të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve të saj.

Ky projekt që buxhetit të Kosovës pritet t'i kushtojë 2.1 milion euro, do të ketë një sipërfaqe prej 4000m² dhe pritet të finalizohet në vitin 2025.



Momente nga vendosja e gurë themelit të objektit të ri të AKK-së nga Kryeministri Kurti

4.2 Vizitat e Ministrit të MMPHI-së

Përderisa Agjencia Kadastrale e Kosovës është pjesë e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vizita e ministrit që udhëheq me këtë ministri është gjithmonë e mirëseardhur. Gjatë vitit 2023 Ministri i MMPHI-së z. Liburn Aliu e ka vizituar AKK-në disa herë.



Momente nga vizita e Minsitrit Aliu në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Ministri Aliu në vizitën e tij të parë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës u informua në detaje për punët dhe aktivitetet e AKK-së, me fokus në projektet kapitale të planifikuara, reformat ligjore, avancimet në sisteme kadastrale dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Ministri u informua po ashtu që Agjencia Kadastrale e Kosovës është duke punuar me ritëm të përshpejtuar në realizimin e objektivave të caktuara, të cilat do të ndikojnë në ngritjen e kualitetit të të dhënave dhe shërbimeve kadastrale.

Në anën tjetër Ministri Aliu, shprehu gatishmërinë për përkrahje dhe mbështetje të plotë për AKK-në në realizimin e suksesshëm të këtyre objektivave.

Ai ishte prezent edhe gjatë vizitës së Kryeminitrit Kurti në AKK, e gjithashtu mori pjesë edhe në punimet e Komitetit Ndërmintrosor për Administrimin e tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës, si dhe funksionalizimin e Zyreve Kadastrale Komunale në Komunitet Veriore.

4.3 Vizita e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Gjatë vitit 2023 Agjencinë Kadastrale të Kosovës e vizituan edhe Deputetët e Komisionit parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, z. Milazim Salihaj, z. Isak Shabani dhe z. Salih Zyba.

Ata u njoftuan me aktivitetet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke përfshirë infrastrukturën ligjore, projektet kapitale, avancimet në sisteme kadastrale dhe aktivitetet e tjera të cilat janë në proces të realizimit.

Në këtë takim u diskutua edhe për Projektligjin për kadastër me të cilin trajtohet një nga problemet më të theksuara në të drejtat pronësore që është informaliteti i lartë. Ky problem do të zgjidhet përmes fuqizimit të rolit të Komisionit për Rindërtimin e kadastrit, i definuar me këtë ligj.



Vizita e deputetëve në AKK

4.4 Komiteti Ndërmëtor për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës

Me Vendimin Nr. 10/94 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të dt. 24.08.2022, është formuar Komitetit për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës. Komiteti kryesohet nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ai është organ koordinues, këshillimor dhe ushtron veprimtarinë e tij sa herë që është e nevojshme për këshillimin e autoritetit përgjegjës lidhur me Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) të Republikës së Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Komitetit janë:

- Ofrimi i këshillave për orientimet kryesore lidhur me administrimin e tokave dhe zhvillimin e avancimin e sistemit të IKIH në Republikën e Kosovës;
- Identifikimi i politikave dhe çështjeve strategjike;
- Ofrimi i këshillave dhe propozimi i politikave të reja, autoriteteve përgjegjëse që kanë të bëjnë me administrimin e tokave dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës;
- Koordinimi dhe monitorimi i të gjitha iniciativave brenda fushës së administrimit të tokës dhe IKIH-së me qëllim të sigurimit dhe harmonizimit të politikave nacionale, lokale, publike dhe private, promovimit të çështjeve specifike për bashkëpunim dhe partneritet publiko privat;
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse në hartimin e Strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës;
- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për kadastër dhe zhvillim të qëndrueshëm, planit të veprimit si dhe Strategjisë për infrastrukturën kombëtare të informacionit hapësinor.

Komiteti për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës, me datë 1 qershor 2023 ka filluar zyrtarisht punimet në takimin e parë koordinues..



Takimi i parë i Komitetit për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor

Në hapje të punimeve të Komitetit, në fjalën e tij hyrëse kryesuesi i Komitetit theksoi rëndësinë e tij dhe qasjen serioze të Qeverisë ndaj Administrimit të Tokës, krijimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinor, si dhe ofrimin e mbështetjes së plotë për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Komitetit dhe entiteteve të tjera institucionale që përbëjnë strukturën koordinuese kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës.

Deri më tani AKK ka ndërmarrë një sërë masash dhe veprime konkrete në avancimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinor, ku edhe organizimi i këtij komiteti përbën një nismë të rëndësishme. Është përmirësuar dukshëm ofrimi i shërbimeve në kohë reale dhe lehtësimi i qasjes në rrjet. Janë mbajtur takime ndër-institucionale për verifikimin e të dhënave dhe identifikim të mundësive për harmonizimin e të dhënave në vend si dhe është krijuar korniza ligjore për menaxhimin e tokës dhe IKIH-së.

Komiteti, do të ushtrojë veprimtarinë e tij në fushat e rëndësishme siç janë identifikimi i politikave dhe çështjeve strategjike, ofrimi i propozimeve të reja lidhur me politikën e administrimit të tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacion Hapësinor, si dhe koordinimin dhe monitorimin e të gjitha iniciativave brenda fushës së administrimit të tokës dhe IKIH-së.

Anëtarët e Komitetit dhe të pranishmit e tjerë shqyrtuan draft rregulloren e punës së komitetit, draft Strategjinë Kombëtare për Informacion Hapësinor, dhe kornizën ligjore rregullative për IKIH. Në takim të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Bankës Botërore, USAID - Aktiviteti i Qeverisjes së Pronës, JICA, GIZ, OSCE dhe Dutch Kadaster.

Ndërsa takimi i dytë i Komitetit për Administrimin e Tokës, dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor në Republikën e Kosovës, u mbajt më datë 19 tetor 2023.

Temë e diskutimit në takimin e Komitetit ishte edhe procesi i Komasacionit, ku nga ky takim u konsiderua e domosdoshme që në Ligjin për Komasacion të përfshihen të gjitha institucionet, dhe të adresohen të gjitha sfidat ekzistuese të komasacionit.

Komiteti aktivitetin e vet e ushtron mbi bazën e Rregullores së Punës së Komitetit. Rregullorja e Punës së Komitetit për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Kosovës është aprovuar në takimin e dytë të Komitetit të mbajtur më datë 19 tetor 2023, ndërsa bazuar në pikën 9 të Vendimit Nr. 10/94 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 24.08.2022, ajo është nënshkruar nga kryesuesi i Komitetit më 14.11.2023.



Takimi i dytë i Komitetit për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor

4.5 Rregullorja e Punës së Komitetit për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës dhe organizimit, detyrat dhe përgjegjësitë, funksionimi, organizimi dhe mbajtja e mbledhjeve të Komitetit si dhe marrëdhëniet e Komitetit me institucionet dhe subjektet përgjegjëse të cilat merren me administrimin e tokave dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor të Republikës së Kosovës.

Komiteti mund të themelojë grupe teknike nga ekspertë për çështje të veçanta që kërkojnë trajtim teknik ose për kryerjen e studimeve apo analizave të nevojshme që ndërlidhen me zhvillimin e sistemit të administrimit të tokës dhe IKIH. Në vendimin për themelimin e grupit teknik të ekspertëve përveç përcaktimit të anëtarëve të grupit, përshkruhen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e grupit. Raporti i punës së grupit të ekspertëve i prezantohet Komitetit në afatin e përcaktuar me vendimin për themelimin.

Rolin e Sekretarisë së Komitetit e luan Agjencia Kadastrale e Kosovës, duke kryer detyrat e përcaktuara me këtë Rregullore.

4.6 Takimi koordinues ndërinstitucional me Kryetarët e të gjitha Komunave të Republikës së Kosovës

Në takim e parë koordinues ndërinstitucional morën pjesë kryetarët e komunave, nënkryetarët dhe drejtorët e drejtorive të kadastrit në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Liburn Aliu, përfaqësues të zyrës së USAID, përfaqësues të nivelit lokal dhe media të ndryshme. Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu, në fjalën e tij, përmendi zhvillimet, planet dhe objektivat në fushën e kadastrit, pronës dhe infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në vend. Tutje ai theksoi se administrimi i tokës, sistemi efikas i kadastrit, ofrimi i shërbimeve publike kadastrale për qytetarët e vendit përmes qasjes e trajtimit të barabartë, si dhe zhvillimi i infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor, përbëjnë thelbin e orientimit të politikave të sektorit të planifikimit hapësinor, infrastrukturës dhe mjedisit. "Administrimi i tokës dhe i informacionit mbi tokën, realizohet përmes një sistemi funksional kadastral në tërë territorin e vendit, për të mundësuar ndërtimin dhe banimin adekuat si komponentë të rëndësishme të kualitetit të jetesës, dhe mirëqenies shoqërore.

Si Ministri e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, edhe më tej do të angazhohemi maksimalisht në ofrimin e mbështetjes së plotë për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për realizimin e reformave në kadastrin shtetëror, ngritjen e kapaciteteve për nivelin lokal, si dhe sigurimin e shërbimeve publike kualitative dhe efikase për qytetarët tanë" u shpreh ministri Aliu.

Z. Sokol Haliti nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, në fjalën e tij theksoi se ky takim do të shërbejë, si mesazh për ngritjen e vetëdijes mbi llogaridhënien publike që të gjithë e kemi karshi votuesve dhe qytetarëve të komunave të cilat i përfaqësojmë, si dhe obligimin ligjor e moral ndaj përmirësimit të qeverisjes së drejtë e demokratike.

Zv. Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së, z. Avni Ahmeti, përmendi para të pranishmëve projektet më të rëndësishme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke përfshirë projektet e Bankës Botërore, RK, kompletimin e sistemit të adresave, avancimin i sistemeve kadastrale, rindërtimin e kadastrit, si dhe korrektimin e të dhënave për persona.



Takimi koordinues ndërinstitucional Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës

Z. Ahmeti tha që Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka identifikuar të gjitha problemet në fushën dhe sektorët që mbulon, duke ofruar zgjidhje për secilën prej tyre. Tutje, ai theksoi rëndësinë e përkrahjes institucionale në nivelin qendror dhe lokal për të bërë ndryshimet e nevojshme.

4.7 Takimet koordinuese me donatorë

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të asistencës financiare e zhvillimore për Administrimin e Tokës në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2023, AKK-ja ka mbajtur dy takime koordinuese me donatorë.

Të pranishëm në këto takime ishin përfaqësues nga Banka Botërore, USAID - Aktiviteti Qeverisja e Pronës, Zyra Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar - JICA, OSBE, GIZ dhe UN Habitat. Pjesëmarrësit në këto takime diskutuan mbi fazat aktuale dhe ato të ardhme lidhur me aktivitet në fushën e kadastrit, programet ekzistuese dhe programet e reja të financimit, të cilat kanë për qëllim avancimin dhe përmirësimin e sektorëve të rëndësishëm në fushën e kadastrit.

Takimet me donatorë do të ndihmojnë Agjencinë Kadastrale të Kosovës në planifikimin e aktiviteteve të rëndësishme, të cilat do të jenë të përqendruara në përmirësimin e sistemit kadastral, përmirësimin e infrastrukturës si dhe në mbështetje e financim të projekteve kapitale në Republikën e Kosovës.



Takimet Koordinuese me Donatorë

4.8 Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucionet Publike

Si rezultat i bashkëpunimit institucional e profesional disa vjeçar mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe institucioneve publike si dhe përdoruesit privat të cilët ofrojnë shërbime publike në fushën e shkëmbimit të të dhënave, respektivisht ofrimit të informacioneve nga regjistrat pronësorë të cilat administrohen nga AKK, janë mbajtur takime të cilat kanë rezultuar me nënshkrimin e memorandumeve për bashkëpunim nëpërmjet të cilëve, bazuar në legjislacionin në fuqi, atyre ju sigurohet qasje në shikim, printim dhe shënim në regjistra pronësore. Ky avancim i mënyrës së bashkëpunimit vjen si rezultat i disa avancimeve që kohëve të fundit ka zhvilluar AKK e që kanë rezultuar me kalimin prej mënyrës tradicionale të ofrimit të të dhënave (CD, email, letër) në mënyrë të avancuar, përmes ofrimit të qasjes në të dhëna në kohë reale dhe përmes ueb shërbimeve. Kjo mënyrë e bashkëpunimit ndërinstitutional do të ngrit shkallën e sigurisë së transaksioneve pronësore, do të shmangen procedurat burokratike, do të ngritët shkalla e transparencës, do të mundësojë ofrimin e të dhënave në kohë reale. Përndryshe, për aspektin teknik të implementimit të këtyre memorandumeve, AKK do të ofrojë edhe trajnime të nevojshme për zyrtarët e institucioneve publike dhe përdoruesit privat të cilët ofrojnë shërbime publike për operim me qasje të limituar në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

Gjatë vitit 2023 AKK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimit me:

- Agjencinë Pyjore të Kosovës

Si dhe Marrëveshje për procedura standarde të operimit (PSO) me:

- 69 Gjeodetë të licencuar dhe
- 3 Kompani gjeodezike



Momente nga nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me APK-në

4.9 Funkcionalizimi i zyrave kadastrale komunale në komunat veriore

Për herë të parë pas 23 viteve funksionalizohet shërbimi kadastral me hapjen e Zyrave Kadastrale Komunale në Komunën e Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut, si dhe rifunksionalizmin e Zyrës Kadastrale Komunale në Mitrovicën e Veriut.

Fillimisht AKK-ja ka përgatitur Planin e Veprimit për funksionalizmin e zyrave kadastrale komunale në komunat veriore i cili i është dorëzuar Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrit të MMPHI-së.

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka arritur të sigurojë pajisjet teknologjike dhe infrastrukturën tjetër përcjellëse, që qytetarët e këtyre komunave të marrin shërbime kadastrale në komunën e tyre.

Hapat që janë ndërmarrë për implementimin e kadastrit në Komunitet e Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut si dhe rifunksionalizimin e shërbimeve kadastrale në Mitrovicën Veriore janë:

- Takimi i përbashkët me Kryetarët e Komunave Veriore më 14.11.2023 me qëllim të informimit të detajuar me punët dhe përgjegjësitë e secilit për funksionalizimin e Zyrave Kadastrale Komunale në komunat që ata udhëheqin;
- Ri-trajnimi i zyrtarëve serb që janë pjesë e AKK-së;
- Sigurimi i zyrave për zyrtarët që do të kryejnë shërbime atje;
- Sigurimi i internetit për kyçe në sistemin zyrtar kadastral;
- Sigurimi i pajisjeve të TI-së;
- Komunitet i kanë pajisur këto zyre me vula të komunave për zyrtarizim të dokumenteve që do tu ofrohen qytetarëve;
- Zyrtarët e AKK-së kanë përkrahur edhe me vizita të rregullta ditore për disa javë.

Në ndërkohë pas pranimit të stafit mbështetës në këto komuna do të mbahen trajnime shtesë edhe për përpunimin e lëndëve për të eliminuar në një kohë sa më të shpejt bartjen e lëndëve nga ZKK në AKK.



Momente nga funksionalizimi i Zyrave Kadastrale Komunale në Komunitet Veriore



Momente nga takimi me Kryetarët e Komunave Veriore

Zyrtarisht puna për ofrimin e shërbimeve kadastrale ka filluar më 27.11.2023, me ç'rast Ministri Liburn Aliu shpërndau Certifikatat e para të Pronësisë dhe Kopjet e Planit tek qytetarët e këtyre komunave.

Në anën tjetër, Agjencia Kadastrale e Kosovës do të vazhdojë mbështetjen e plotë për të gjitha komunitet e Republikës së Kosovës dhe mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve sa më të mira kadastrale dhe sa më afër qytetarëve.

Në vetëm 4 ditë të javës së parë të hapjes së zyrave, u vërejt interesim i madh i qytetarëve për t'u pajisur me Certifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Nr.	ZKK	Nr. Certifikatave të pronësisë	Nr. Kopjeve të planit
1	Leposaviq	53	70
2	Mitrovicë Veriore	56	61
3	Zubin Potok	8	8
4	Zveçan	16	15



5

PROJEKTET
KAPITALE

5. PROJEKTET KAPITALE

Agjencia kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2023 ka filluar realizimin e disa projekteve kapitale, e gjithashtu ka përgatitur specifikat teknike dhe ka bërë përgatitjet e tjera teknike e ligjore për fillimin edhe të shumë të tjerave gjatë vitit 2024. Një përshkrim më i detajuar për secilin nga këto projekte është paraqitur në vijim.

5.1 Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës

Bazuar në praktikën dhe zhvillimet e shpejta në Republikën e Kosovës, parashikohet që aerofotografimi i territorit të vendit të kryhet çdo 3-5 vjet.

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka filluar realizimin e projektit të aerofotografimit të territorit të Republikës së Kosovës i cili pritet të përfundojë në shtator të vitit 2024.


Ky projekt ka një kërkesë të veçantë për të kryer aerofotografinë me saktësi të lartë, ku të dhënat e fituara do të shfrytëzohen në shumë fusha. Të dhënat e fituara në kuadër të këtij projekti do të shfrytëzohen gjithashtu në projektet e ardhshme.

Pas nënshkrimit të kontratës, u organizua një takim fillestar, në të cilin u diskutuan kryesisht:

- Marrja e lejeve të fluturimit;
- Planifikimi i realizimit të fluturimit;
- Planifikimi dhe realizimi i sinjalizimit të GCP-ve në terren.

Projekti është i ndarë në katër kategori:

- Zonat rurale: 5 blloqe me një sipërfaqe totale prej 10,134 km²;
- Zonat urbane: 25 blloqe me një sipërfaqe totale prej 1,026 km²;
- Zona rurale Krushë e Madhe, me një sipërfaqe prej 7.5 km²;
- Zona urbane e Prishtinës, me një sipërfaqe prej 4.8 km².



Planet e fluturimit “Zonat Rurale” dhe “Zonat Urbane”


5.2 Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive

Një ndër komponentët më të rëndësishme dhe të domosdoshme për përfundimin dhe përcaktimin të Sistemit Referent të Lartësive, krahas rrjetit referent GNSS dhe Rrjetit Gravimetrik është zhvillimi i rrjetit të nivelimit në Republikën e Kosovës.

Prandaj, objektivi është kompletimi i rrjetit të nivelimit si bazë e domosdoshme për nevoja tona por edhe fakti që si shtet mos të mbesim prapa në zhvillimet regjionale në këtë fushë, pasi që shumica e shteteve të regjionit tashmë e kanë kompletuar këtë aktivitet.

Me këtë projekt kompletohen Rrjetat gjeodezike në territorin e Republikës së Kosovës.

Të dhënat nga rrjeti i nivelimit do të shërbejnë për matje të precizitetit të lartë. Gjatësia e vijës së nivelimit të precizitetit të lartë është 800 km, në kuadër të së cilës vijë do të stabilizohen: 5 pika themelore, 50 pika nyje dhe 350 pika të zakonshme.



Harta e linjave të projektuara të nivelimit

5.3 Avancimi i sistemeve kadastrale

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar një sistem të avancuar për regjistrimin e pronës së paluajtshme në vend “Sistemi Informativ Kadastral i Tokës së Kosovës” (SIKTK). Ky sistem pritet të avancohet me module të reja për shërbime sa më cilësore, të sakta, transparente dhe të shpejta për qytetarët e Republikës së Kosovës. Sistemi është krijuar për të ndërvepruar me sistemet e institucioneve dhe grupeve të tjera të interesit për qasje në të dhënat kadastrale.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është që të avancohen, përmirësohen, dhe përditësohen sistemet digjitale kadastrale.

Përmirësimi i funksionalitetit të sistemeve ekzistuese - Fokusi është të bëhen ndryshime në sistemet e informacionit për administrimin e tokës, për të rritur performancën dhe menaxhimin e cilësisë së të dhënave për të gjitha sistemet. Disa nga sistemet e informacionit përdorin teknologji të vjetër dhe duhet të përmirësohen me teknologjinë më të re, në mënyrë që të kenë funksionalitete të reja dhe performancë më të mirë. Një tjetër përmirësim i sistemeve është ndryshimi i rrjedhës së punës për ta bërë më të lehtë dhe më fleksibil përdorimin e tyre.

Përmirësimi i interoperabilitetit të sistemit, veçanërisht me sistemet e jashtme - Nga komunikimet aktuale me sisteme të jashtme, është vërejtur se cilësia e të dhënave është rritur dhe procesimi i të dhënave është shumë i shpejtë. Kjo ka ndihmuar përdoruesit e fundit të kenë të dhënat nga sistemet e jashtme të verifikuara plotësisht dhe të përditësuara. AKK-ja është e fokusuar në rritjen e numrit të institucioneve publike dhe private për të komunikuar me to në kohë reale, pasi që shkëmbimi i të dhënave do të jetë me cilësi të lartë dhe të gjitha palët e interesit do të marrin të dhënat në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë.

Ridizajnimi i modelit të të dhënave, në përputhje me standardin ISO 19152 LADM - Disa nga bazat aktuale të të dhënave janë në përputhje me standardin LADM, por ende kanë nevojë për disa përmirësime dhe avancime për të përmbushur më mirë standardin LADM. Baza aktuale e të dhënave do të analizohet dhe do të vendoset se çfarë mund të përmirësohet, por pa bërë ndryshime rrënjësore, pasi ka të dhëna të ruajtura në ato baza të të dhënave dhe duhet siguri në konvertimin dhe migrimin e tyre pa humbur asnjë informacion.

Ky projekt është duke mbështetur përmirësimin e Infrastrukturës Referente Gjeodezike në Kosovë dhe themelimin e Sistemit të Referencës Gjeodezike të Kosovës sipas standardeve të BE-së.

Objektivi final është krijimi i një sistemi modern referent të lartësive në tërë territorin e Kosovës.

Gjatë këtij viti është përfunduar rekognozimi dhe vendosja e monumenteve gjeodezike në terren.

Një ndër aktivitetet e këtij projekti është edhe zhvillimi i mëtejshëm dhe ndërveprimi i sistemeve digjitale me regjistrat dhe sistemet e tjera, zhvillimi i shërbimeve elektronike, përfshirë ndërveprimin me SIKTK dhe Gjeoportalin për IKIH, përmirësimi i proceseve të biznesit dhe modifikimet për të mbuluar regjistrimin e të dhënave në kadastër.

Sistemet e informacionit:

- **SIKTK-T** — përmes këtij sistemi menaxhohen të dhënat tekstuale të informacioneve kadastrale, ku pjesë përbërëse është edhe menaxhimi i lëndëve për pjesën tekstuale dhe grafike. Ky sistem do të avancohet me module të reja për të menaxhuar të dhënat që vijnë si të dhëna digjitale nga institucionet e jashtme. Këtu parashihet të integrohen të dhënat nga noterët, gjeodetët dhe kompanitë gjeodezike të licencuara për të përpunuar kërkesat e tyre në formatin digjital, ku natyrisht që do të rritet në masë të madhe kualiteti i të dhënave kur bëhet komunikimi digjital në mes të sistemeve të informacionit. Një tjetër komunikim do të parashihet të jetë edhe me Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përmbaruesit privat, etj. Do të bëhet një integrim i gjeneralizuar që në të ardhmen kur shtohen institucione të mund të menaxhohen ato pa patur nevojë të bëhen ndryshime në sistem.
- **SIKTK-HK** — përmes këtij sistemi menaxhohen të dhënat grafike të njësive kadastrale për të përditësuar ato dhe mirëmbajtja e tyre. Do të avancohet me teknologjitë e fundit në mënyrë që të reduktohen shume hapa në rrjedhën e punës dhe të rritet kualiteti i të dhënave. Performanca e sistemit do të rritet dukshëm pasi që aktualisht ky sistem shpeshherë është ngulfatur për shkak të mbingarkesave të shumta, meqenëse janë rritur në vazhdimësi transaksionet dhe qasja e përdoruesve të fundëm në këtë sistem. Do të bëhet edhe integrimi dhe komunikimi digjital për të ofruar të dhëna digjitale për institucione të ndryshme, ku do të bëhet edhe komunikimi në kohë reale për gjeodetët dhe kompanitë gjeodezike të licencuara për të pranuar kërkesat nga ata dhe për tu dhënë mundësinë që të shkarkojnë të dhëna nga ky sistem.
- **SIRA (ARIS)** — përmes këtij sistemi menaxhohen, përditësohen dhe mirëmbahen të dhënat e adresave. Ky sistem do të avancohet me teknologjitë e fundit dhe do të jetë i mundshëm për mundësinë e qasjes në të njëjtën kohë të shumë përdoruesve. Do të shtohen funksionalitete dhe mundësi të reja, avancim i rrjedhës së punës, etj.


- **Sistemi i informacionit për gjeodetë** — do të jetë një sistem i ri, që do të shfrytëzohet nga gjeodetët dhe kompanitë gjeodezike të licencuara për të konsumuar të dhënat grafike dhe tekstuale nga SIKTK-T dhe SIKTK-HK, ku do të iu mundësohet përditësimi i këtyre të dhënave dhe dërgimi i tyre në ZKK në formë digjitale. Të gjitha këto komunikime do të realizohen në kohë reale.
- **Regjistri i përçojave** — do të jetë modul i ri për të menaxhuar regjistrin e të dhënave kadastrale të përçojave. Do të ketë dhe funksionalitete të tjera të importimit të të dhënave masive të përçojave, në mënyrë që të mund të merren këto të dhëna nga institucione publike dhe private të cilat tashmë kanë të dhëna mbi përçojat. Do të ketë mundësi që gjatë gjenerimit të certifikatave të pronës dhe kopjeve të planit të ketë mundësi sipas zgjedhjes së përdoruesit që të shfaqen edhe përçojat varësisht prej kërkesës.
- **SIKTK — Online** - është një sistem i qasshëm nga institucionet që kanë marrëveshje me AKK-në për konsumimin e të dhënave. Do të shtohen shumë mundësi të reja ku do të shfaqen të dhëna përmes internetit, dhe shtimi i funksioneve të reja për shfrytëzuesit që tashmë kanë marrëveshje me AKK-në. Këtu do të përfshihen noterët, përmbaruesit, KGJK, KPK, etj. Ata do të kenë mundësi që në kohë reale të mund të marrin informata drejtëpërdrejt nga sistemet kadastrale që ka AKK, të kenë mundësi përpunimin e atyre të dhënave, dhe për të dërguar kërkesat në formë digjitale në sistemet kadastrale, ku ZKK të mund të bëjë verifikimin dhe aprovimin/refuzimin e kërkesave. Kjo do të rrit në masë të madhe kualitetin e të dhënave dhe do të thjeshtësojë procedurat administrative në mënyrë që qytetarët të mos kenë nevojë që fizikisht të dorëzojnë kërkesat e tyre nëpër ZKK.
- **SIKTK-API** - do të jetë avancimi i API-ve dhe mundësia për të dhënë qasje institucioneve të jashtme për të komunikuar në formë digjitale në kohë reale me sistemet e informacioneve kadastrale. Ky projekt është në procedurë të prokurimit.

5.4 Korrektimi/përmirësimi i të dhënave në SIKTK-T

Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet kadastrale në Kosovë dhe ka autoritet të nxjerrë udhëzime lidhur me to, për administrimin e sistemit shtetëror të bazuar në sisteme kompjuterike që mbledhin, përpunojnë dhe shpërndajnë të dhënat kadastrale. Bazuar në përgjegjësitë e AKK-së sipas legjislacionit dhe duke marrë parasysh gjendjen e të dhënave kadastrale, është propozuar që të zhvillohet një projekt që do të identifikojë dhe korrigjojë të dhënat kadastrale dhe do të plotësojë të dhënat jo të plota për personat në pjesën tekstuale të Sistemit Informativ Kadastral të Tokës së Kosovës (SIKTK-T).

Të dhënat kadastrale tekstuale dhe gjeohapësinore të mbajtura nga AKK-ja në Kosovë kanë kaluar nëpër disa sisteme nga periudha e pasluftës e deri më sot. Meqenëse sistemet kanë avancuar gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës, por edhe trajnimi profesional i zyrtarëve të zyrave kadastrale komunale ka shënuar një avancim gjithnjë në rritje, natyrshëm ka lindur nevoja për përmirësimin/plotësimin e të dhënave. Pothuajse gjysma e “personave” (pronarët, shfrytëzuesit, qiramarrësit) të identifikuar në SIKTK-T janë të regjistruar me një kod identifikimi (KCID), i cili nuk është i njëjtë me numrin personal zyrtar ose numrin e biznesit të mbajtur nga Agjencia e Regjistrimit Civil ose Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve. Ky kod është gjeneruar automatikisht nga sistemet e mëparshme të AKK-së. Korrigjimi dhe plotësimi i të dhënave të pronarëve në SIKTK T është prioritet i AKK-së për vitin 2024.

Paraprakisht për të krijuar bazën ligjore për realizim të këtij projekti është miratuar ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MMPH — NR. 11/19 për Ndarjen e Ndërtesës dhe të Pjesës së Ndërtesës si dhe ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës. Është hartuar edhe drafti i Specifikave Teknike të cilat janë aprovuar nga Banka Botërore dhe projekti është në procedurë të prokurimit.




**DATA
QUALITY**

5.5 Zhvillimi i Gjeoportalit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH) dhe përditësimi i Gjeoportalit ekzistues të AKK-së

Bazuar në Ligjin nr. 08/I-010 për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve për shfrytëzim të informacioneve hapësinore, AKK është përgjegjëse për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Gjeoportalit për IKIH.

Gjeoportali për IKIH ndërlidh shërbimet në ueb për secilën nga temat e përcaktuara me Ligj. Përmes Gjeoportalit për IKIH, autoriteteve publike u mundësohet: menaxhimi i meta të dhënave, e drejta për kërkim dhe shikim, e drejta për shkarkime dhe futja e informacioneve hapësinore, si dhe informacioneve tjera të cilat kanë të bëjnë me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor.



Gjeoportali do të paraqesë informacion nga burime të ndryshme në një mënyrë të unifikuar. Përmes Gjeoportalit do të shpërndahen të gjitha informacionet hapësinore nga institucionet përgjegjëse në Kosovë, sipas dispozitave të Ligjit nr. 08/I-010 për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, në përputhje me Direktivën INSPIRE.

Janë përgatitur Specifikat Teknike për Zhvillimin e Gjeoportalit të IKIH-së dhe së shpejti do të fillohet me procedura të prokurimit.

5.6 Furnizimi me pajisje gjeodezike për matje

Pasi që AKK është institucion i vetëm shtetëror përgjegjës për fushën e matjeve dhe hartografisë, është paraparë që AKK të furnizohet me pajisje moderne gjeodezike për matje. Në kuadër të këtij projekti është bërë furnizimi me një Dron të teknologjisë së avancuar për prodhim të të dhënave gjeohapsinore për sipërfaqe jo shumë të mëdha (disa kilometra katrorë) por me nevoja specifike të AKK-së dhe institucioneve tjera shtetërore. Gjithashtu është bërë furnizimi edhe me pajisje GNSS dhe nivelë digjitale për matje saktësisë së lartë. Këto pajisje do të përdoren për kontroll të kualitetit për projekte të ndryshme në fushën e matjeve. Kontrata për këtë aktivitet është nënshkruar më 25 shtator 2023.

5.7 Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik

Qëllimi i projektit është të hartohet dhe implementohet një plan i veprimit të ndërjegjësimit dhe komunikimit, për të rritur kapacitetin e AKK-së dhe ZKK-ve për të komunikuar me publikun dhe me palët e tjera të interesit. Fillimisht, gjatë vitit 2022 është hartuar Plani i Veprimit për Informim Publik, dhe momentalisht është duke u zhvilluar procedura e prokurimit për implementimin e këtij Plani të Veprimit.

5.8 Zgjerimi i qendrës së të dhënave të AKK-së (Hardware+Software)

Shërbimet dhe sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë të hostuara në Qendrën e të dhënave Primare (në AKK), dhe gjithashtu sistemet kryesore të TI-së replikohen në qendrën e rimëkëmbjes e cila gjendet në ndërtesën e Rilindjes. Meqë e gjithë infrastruktura e lartpërmendur është implementuar në vitin 2016 dhe duke pasur parasysh që pajisjet janë liferuar me garancion 3 vjeçar, është e domosdoshme zëvendësimi i tyre sa më parë për të mos shkaktuar ndërprerje apo humbje të shënimeve. Gjithashtu, me këtë projekt pritet që të përmbushen kërkesat për infrastrukturë të TI-së (harduer- HW dhe softuer-SW) për projektet e shumta të cilat janë në proces dhe ato që pritet të zhvillohen në Agjencinë Kadastrale të Kosovës si: SIKTK-T, ARIS, Aerofotografimi, Gjeoportali, RK (Rindërtimi i Kadastrit), KN (Kadastri i Ndërtesave), skanimi masiv i dokumenteve etj.

Shumica e këtyre projekteve kërkojnë nga tri ambiente pune, atë për zhvillim, për testim dhe atë real (të prodhimit). Përveç këtyre duhet të përmendet edhe ambienti për trajnim që është i konfiguruar dhe do të avancohet. Ky projekt aktualisht është në procedurat finale të prokurimit.

5.9 Sistemi i unifikuar i adresave

Projekti i Bankës Botërore për Kompletimin e Sistemit të Adresave

Projekti i Bankës Botërore për Sistemin e Adresave përbëhet nga disa komponentë, siç janë:

- Matja e rrugëve të reja në teren dhe përditësimi i tyre në sistemin ARIS;
- Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave (rrugët, numrat e hyrjeve, adresimi i brendshëm);
- Kompletimi i emrave të rrugëve dhe numrave të adresave me tabela (në komunat e mbetura);
- Ndërlidhja e Regjistrimit Civil me Regjistrin e Adresave (përmes Aplikacionit SELQA);
- Zhvillimi i mobil aplikacionit/navigationit për Kosovë (ARIS Mobile).
- Me qëllim të koordinimit sa më të mirë dhe shpërndarjes së përgjegjësisë për të realizuar projektin e kompletimit të Sistemit të Adresave, janë nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit me institucione të ndryshme siç janë komunat, Zyrën e Kryeministrit, përkatësisht Zëvendëskryeministrit, Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Agjencinë e Statistikave.

Matja e rrugëve të reja në teren dhe përditësimi i tyre në Sistemin ARIS

Një prej aktiviteteve të para dhe si parakusht për realizimin e aktiviteteve tjera është matja e rrugëve të reja dhe përditësimi i tyre në sistemin ARIS. AKK-ja fillimisht ka hartuar termat e referencës për matjen e rrugëve në teren. Pastaj, është angazhuar kompania që ka bërë matjen e rrugëve në teren, sipas skicave të mëhershme të digjitalizuara nga komunat. Më pas, është bërë postprocesimi i të dhënave dhe është bërë bashkimi me shtresën aktuale të rrugëve në ARIS. Sipas statistikave të nxjerra në ARIS, komunat kanë skicuar rreth 635,628 metra rrugë, kurse janë matur rreth 797,165 metra rrugë.

Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave (Rrugët, Numrat e Hyrjeve, Adresimi i Brendshëm)

Njëri nga aktivitetet më të rëndësishme në kuadër të projektit të Adresave është mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave. Edhe pse ligjërisht komunat janë përgjegjëse për përditësimin e të dhënave të adresave, duke pasur parasysh se ato nuk kanë kryer këtë përditësim për një kohë të gjatë për shkak të arsyeve të ndryshme si mungesa e stafit dhe mos përdorimi i adresave zyrtare, AKK ka mbështetur komunat me staf mbështetës për mbledhjen e të dhënave të adresave të reja në teren dhe për ndihmën në digjitalizimin e tyre në ARIS përmes projektit të Bankës Botërore.

Përditësimi i të dhënave është bërë përmes angazhimit të 54 Konsulentëve të cilët kanë mbledhur të dhëna nga terreni.

Procesi i përditësimit vazhdon në komunat Prizren, Klinë, Istog dhe Shtërpçë deri në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm.

Më poshtë janë paraqitur të dhënat e adresave të reja në formë tabelare sipas komunave:


Nr.	Komuna	Para përditësimit		Nëntor 2023			
		Rrugë	Hyrje	Rrugë	Hyrje	Hyrje të reja	% e hyrjeve të reja
1	Kllokot	72	920	72	1380	460	50
2	Mamushë	40	862	40	1193	331	38
3	Novobërdë	172	3247	173	4337	1090	34
4	Graçanicë	290	5406	290	7039	1633	30
5	Shtime	282	6076	282	7813	1737	29
6	Viti	376	12136	376	15144	3008	25
7	Suharekë	1358	16233	1366	20030	3797	23
8	Pejë	945	24906	944	30537	5631	23
9	Deçan	593	8346	595	10191	1845	22
10	Gjakovë	970	23375	970	28252	4877	21

11	Gjilan	986	26514	1002	32026	5512	21
12	Lipjan	675	15240	675	18205	2965	19
13	Dragash	454	11039	453	13150	2111	19
14	Skenderaj	686	11338	686	13478	2140	19
15	Junik	55	1158	75	1367	209	18
16	Podujevë	1186	26755	1180	31237	4482	17
17	Obiliq	399	6085	401	7032	947	16
18	Ferizaj	1431	31246	1510	36105	4859	16
19	Fushë Kosovë	369	9405	369	10532	1127	12
20	Prishtinë	2214	51942	2265	57157	5215	10
21	Kaçanik	437	8265	437	9049	784	9
22	Vushtrri	1376	19885	1385	21734	1849	9
23	Mitrovicë Jugore	755	20272	755	22085	1813	9
24	Rahovec	518	14644	518	15948	1304	9
25	Hani Elezit	69	2134	69	2312	178	8
26	Kamenicë	556	10566	556	11290	724	7
27	Glllogoc	764	12249	784	12944	695	6
28	Ranillug	99	1671	99	1758	87	5
29	Malishevë	861	15053	875	15384	331	2
30	Klinë	422	11471	422	11714	243	2
31	Istog	468	12328	468	12433	105	1
32	Prizren	1634	43262	1637	43286	24	0
33	Shtërpçë	196	3976	196	3978	2	0
34	Partesh	62	1115	62	1115	0	0

Në 29 komuna, digjitalizimi i të dhënave në ARIS është përfunduar, ndërsa në 4 komuna vazhdon digjitalizimi. Në 4 komuna veriore nuk janë përfshirë në projekt, ndërsa komuna e Parteshit nuk ka bashkëpunuar në projekt dhe nuk është bërë përditësimi i të dhënave.


Kompletimi i emrave të rrugëve dhe numrave të adresave me tabela në komunat e mbetura

Prodhimi, instalimi dhe mirëmbajtja e tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave është ligjërishit përgjegjësi e komunave. AKK, përmes donatorëve të ndryshëm, ka mbështetur komunat në sinjalizimin e adresave. Sa i përket vendosjes së tabelave të emrave të rrugëve, ai ka përfunduar në 31 komuna. Në kuadër të këtij aktiviteti është paraparë edhe që të bëhet prodhimi dhe instalimi i tabelave të emrave të rrugëve në 3 komuna (përfshirë 4 komunat veriore). Sa i përket tabelave të numrave të adresave, ka përfunduar në 12 komuna, kurse në 6 komuna ka përfunduar pjesërisht. Në 22 komuna pritet të vendosen numrat e adresave (duke përfshirë 4 komunat veriore). Në kuadër të aktivitetit për sinjalizimin e adresave janë paraparë të prodhohen dhe instalohen rreth 1530 tabela të emrave të rrugëve në 3 komuna dhe rreth 380,000 tabela të numrave të adresave në 22 komuna. Në grafikun e më poshtëm paraqitet statusi i vendosjes së tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të hyrjeve në Kosovë:



Përqindja e hyrjeve të reja sipas komunave

Është e rëndësishme të theksohet se një nga komunat ku ka sfida rreth sinjalizimit të adresave është komuna e Novobërdës, e cila ende nuk ka aprovuar emrat e rrugëve dhe rrjedhimisht nuk ka mundësi për sinjalizim të adresave.




Ndërlidhja e Regjistrimit Civil me Regjistrin e Adresave (përmes Aplikacionit SELQA)

Duke parë rëndësinë shumë të madhe të lidhjes së qytetarit me adresë zyrtare, AKK ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar për këtë proces, si dhe ka përpiluar Memorandumin e Bashkëpunimit, projekt propozimin, procedurat standarde të veprimit dhe termat e referencës për mbledhjen e të dhënave në teren.

Qëllimi i ndërlidhjes së dy regjistrave është që qytetarët të pajisen me adresa zyrtare në regjistrin civil dhe më pas përmes regjistrimit civil, adresat të shpërndahen dhe të përditësohen edhe në bazat e të dhënave të institucioneve dhe kompanive tjera me adresa zyrtare. Për të realizuar ndërlidhjen e dy regjistrave, palët (ZKM, AKK dhe ARC) janë pajtuar që të realizojnë një pilot projekt me mbështetje të GLZ-it në komunat Istog dhe Mitrovicë e Jugut. Pilot projekti ka përfshirë krijimin e një aplikacioni të ndërmjetëm për ndërlidhje dhe mbledhjen e të dhënave në teren.

Rezultatet e nxjerra nga ky pilot projekt do të shërbejnë për realizimin e projektit për ndërlidhjen e qytetarit me adresa në tërë territorin e Kosovës.



6

ZHVILLIMET / AVANCIMET
NË SISTEME
KADASTRALE

6. ZHVILLIMET/ AVANCIMET NË SISTEME KADASTRALE

Thjeshtësimi dhe lehtësimi i procedurave administrative për ofrimin e shërbimeve kadastrale për qytetarë

Edhe në vitin 2023 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka vazhduar angazhimin për shërbime më të mira për qytetarë dhe avancim të sistemeve kadastrale.

Këto zhvillime nga Agjencia Kadastrale e Kosovës vijnë në kuadër të reformave në këtë fushë. Insistimi për zhvillime e avancime të reja me qëllim digjitalizimin e procedurave dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët kanë sjell disa zhvillime të reja gjatë këtij viti të cilat do të sqarohen më detajisht në vazhdim.

6.1 Kufizimi në regjistra kadastral për ruajtjen e radhës së aplikimit

Gjatë këtij viti AKK-ja ka zhvilluar dhe publikuar avancimin e radhës në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK) me titull “trajtimi i kërkesave sipas radhës”, pra kush aplikon i pari do të shërbehet i pari në ZKK.

Në mënyrë që të ruhet radha e lëndëve dhe me këtë rast të sigurohet drejtësi për të gjithë qytetarët që aplikojnë për shërbime kadastrale AKK-ja për lëndët që dorëzohen në ZKK ka kufizuar mundësinë që zyrtarët në ZKK të mos e respektojnë kohën e dorëzimit të tyre.



6.2 Gjurimi i lëndëve që dorëzohen nga qytetarët në ZKK

Që nga ky vit qytetarët e Republikës së Kosovës do të mund të gjurmojnë lëndën e dorëzuar në kadastrë nëpërmjet formës elektronike në ueb faqen e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Ky sistem është i qasëshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës me një klik nga shtëpitë e tyre.


Para zhvillimit të kësaj mundësie, mënyra e vetme për informim për kërkesat e tyre ishte nëpërmjet vizitës së drejtpërdrejtë në zyrën kadastrale komunale.

Pra, secila kërkesë drejtuar zyrave kadastrale komunale do të mund të gjurmohet nga aplikuesi në kohë reale. Mjafton që secili aplikues në momentin që dorëzon kërkesën në ZKK, të shënojë edhe numrin e telefonit dhe në momentin që kërkesa regjistrohet si kërkesë e re në Regjistrin e të drejtave pronësore, aplikuesi do të ketë mundësi që ta përcjellë statusin e lëndës së tij. Përmes sms-it do i përcillet numri referent i lëndës bashkë me linkun për kyçje në sistemin për gjurmim. Duke klikuar në këtë link e duke shënuar numrin referent do shfaqet statusi i lëndës së dorëzuar në zyrën kadastrale komunale.

Me këtë mundësi qytetari do të informohet për statusin e lëndës në çdo kohë 24/7, pa pasur nevojë të shkojë në ZKK.

Përveç statusit të lëndës qytetarët do të mund të informohen edhe me arsyen e refuzimit eventual të kërkesës së tyre. Pra bashkë me hapat e ndjekur nga kërkesa do të mund të kuptojnë edhe se cilat kushte nuk janë plotësuar për regjistrimin e të drejtës pronësore apo çfarëdo lloj lënde tjetër për të cilën kanë aplikuar.

Ky zhvillim do t'ju shërbejë edhe gjeodetëve të licencuar në punën e tyre të përditshme, për lëndët të cilat i dorëzojnë në zyrat kadastrale komunale.



6.3 Shënimi nga ana e Noterëve dhe Përmbauesve privat

Listës së avancimeve të AKK-së për 2023, i shtohet edhe mundësia e regjistrimit të shënimit nga Noterët dhe Përmbauesit privat në SIKTK - T. Vendosja e këtij shënimi në regjistrin e të drejtave pronësore do të ngrisë nivelin e sigurisë së transaksioneve dhe do të ndihmojë në parandalimin e krijimit të dy ose më tepër akteve noteriale për njësitë e njejta kadastrale, përkatësisht të atyre përmbauesve.

Agjencia Kadastrale e Kosovës fillimisht ka mbajtur trajnim për të gjithë Noterët dhe Përmbauesit privat të Republikës së Kosovës.

Meqë fokusi i AKK-së do të jetë digjitalizimi i shërbimeve kadastrale, Noterët poashtu u njoftuan edhe me angazhimin e institucionit tonë për të zhvilluar modulën e ri nëpërmjet të cilit regjistrimi i të drejtave pronësore në regjistër do të bëhet nga vetë ata.

Nga data 01.07.2023 kur është krijuar mundësia e vendosjes së shënimit për aktet juridike nga ana e noterëve në Regjistrin Kadastral janë evidentuar 16606 shënime noteriale.

- Lëndë për shënimin për Transaksione janë 15554.
- Lëndë për shënimin për Hipotekë janë 1052.

6.4 Produktet kadastrale në e-Kosova: Certifikatat e pronësisë, kopjet e planit dhe Koordinatat e njësive kadastrale

Si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe në ndërveprim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, lista e shërbimeve pronësore të disponueshme “online” në platformën eKosova ka përfshirë shërbime të reja.

Përveç Certifikatës mbi të drejtat pronësore në pronën e paluajtshme dhe Kopjes së Planit që janë në shërbim të qytetarëve nga viti 2022, tani qytetarëve të Republikës së Kosovës u ofrohen edhe shërbimet e mëposhtme “online”:

- Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme për anëtarë të familjes,
- Koordinatat e njësisë kadastrale,
- Koordinatat e njësisë kadastrale për anëtarë të familjes,
- Kopja e planit dhe kopja e planit për anëtarë të familjes.


Këto shërbime paraqesin një përparim të rëndësishëm në sigurimin cilësor dhe në kohë reale të produkteve pronëso-juridike dhe kadastrale për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Si pasojë e kërkesave dhe ankesave të pranura nga qytetarët, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka mundësuar që në platformën online eKosova, të ofrohet edhe shërbimi i nxjerrjes së Certifikatës së Pronës, Kopjes së Planit dhe Koordinatave të Njësive Kadastrale. Këto dokumente janë të barasvlershme me ato që mund të merren fizikisht në Zyrën Kadastrale Komunale. Të hyrat nga ky shërbim në platformën eKosova do të inkasohen në llogarinë e secilës komunë ku ndodhet pronë e paluajtshme.

Statistika të cilat paraqesin nivelin e shfrytëzimit të këtyre shërbimeve janë si në vijim:

- Certifikata për person të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 946.
- Certifikata për njësi të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 4622.
- Kopje plani për njësi të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 1943.
- Koordinatat e njësisë të lëshuara nga platforma eKosova janë gjithsej 311.

Në proces të integrimi në eKosova janë edhe shërbimet e reja : certifikata , kopja e planit dhe koordinatat për bizneset



6.5 Digjitalizimi i regjistrimit të barrës tatimore në Regjistrin e të drejtave pronësore

Në përpjekje për avancimin dhe digjitalizimin e shërbimeve për qytetarët, si dhe për përmirësimin e komunikimit mes institucioneve, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka zhvilluar Modulin e Regjistrimit të Barrës Tatimore në formë elektronike. Ky bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës ka sjellë një zhvillim të rëndësishëm që synon digjitalizimin e regjistrimit të barrës tatimore në tërësi, duke regjistruar këtë ngarkesë në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, në formë shumë të thjeshtë e të shpejtë. Forma dhe mënyra e përdorimit të këtij moduli u prezantua edhe për zyrtarët e Zyrate Kadastrale Komunale dhe pas trajnimit dhe informimit të rreth 70 zyrtarëve të ZKK-ve, gjatë vitit 2023 ka filluar implementimi.

Ky hap vjen pas suksesit të implementimit të digjitalizimit të formës së Regjistrimit të hipotekave nga bankat, institucionet mikrofinanciare dhe kompanitë e sigurimeve. Gjithashtu, ky zhvillim vazhdon përpjekjet e filluara në digjitalizimin e procedurave të regjistrimit, dhe pritet të kalojë edhe në institucione të tjera që dorëzojnë kërkesa për regjistrim në SIKTK.

Këto avancime synojnë të ofrojnë shërbime sa më të mira dhe efikase për qytetarët, duke lehtësuar gjithashtu punën e zyrtarëve nëpër Zyrat Kadastrale dhe duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së të dhënave në Regjistrin e të Drejtave Pronësore.

Statistikat për periudhën janar-nëntor 2023 të shfrytëzimit të sistemit online për regjistrimin dhe fshirjen e barrës tatimore janë si në vijim:

- Kërkesa të ardhura nga ATK në SIKTK janë: **485 lëndë**
- Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK: **19 lëndë**
- Regjistrimi i ngarkesës tatimore: **276 lëndë**

6.6 Vërtetimi i tatimit në pronë nuk duhet dorëzuar si dëshmi në ZKK për të marrë shërbime kadastrale

Shfuqizimi i Rregullores (QRK) Nr. 07/2021 për Pezullimin e Shërbimeve Komunale për Mbledhjen e Detyrimeve të Papaguara të Tatimit në Pronë, ka mundësuar që Zyrat Kadastrale Komunale më të mos kërkojnë vërtetimin për pagesën e tatimit në pronë, për të gjitha shërbimet kadastrale.

Edhe ky aktivitet është pjesë e punës intensive që AKK-ja ka realizuar këtë vit me qëllim të thjeshtësimit të procedurave administrative, reformimin ligjor dhe digjitalizimin e shërbimeve.

Kjo çështje ka qenë njëra nga temat e Komitetit për praktika të mira i udhëhequr nga Agjencia Kadastrale dhe i përkrahur nga USAID.

6.7 Shkurtohet lista e dokumenteve për dorëzim në ZKK

Duke filluar nga 1 dhjetori 2023, është shkurtuar lista e dokumenteve që duhet dorëzuar në Zyre Kadastrale Komunale nga qytetarët dhe gjeodetët e licencuar

Me qëllim të thjeshtësimit të procedurave administrative, AKK-ja i ka njoftuar ZKK-të dhe gjeodetët e licencuar që për të gjitha lëndët e azhurnimeve nuk është e obligueshme që në ZKK të dorëzohen Certifikata e Pronësisë dhe Kopja e Planit.

Gjithashtu, në ZKK si kopje fizike të dokumentacionit nuk është e nevojshme të dorëzohet as kopja e licencës dhe kopja e letërnjoftimit të gjeodetit të licencuar, mjafton që ato të dorëzohen vetëm në formë digjitale në CD.



**NGRITJA E KUALITETIT
TË TË DHËNAVE**

7

7. NGRITJA E KUALITETIT TË TË DHËNAVE

Analiza dhe korrigjimi i të dhënave kadastrale

Në përpjekje të vazhdueshme për të siguruar cilësi dhe saktësi të të dhënave kadastrale, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka bërë një analizë dhe monitorim të detajuar të të dhënave tekstuale në SIKTK T.

Stafi i AKK-së vazhdon të angazhohet për përmirësimin e kualitetit të të dhënave kadastrale që të sigurojë saktësi maksimale të tyre.

7.1 Korrigjimi/unifikimi i personave të regjistruar dy e më tepër herë në SIKTK me të njëjtin numër personal

Pas ankesave nga qytetarët dhe pas analizës së të dhënave nga grupi i ekspertëve të AKK-së, menaxhmenti i AKK-së ka vendosur të fillojë procesin e unifikimit të të dhënave nga stafi i vet, pasi që në Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK) nuk do të ketë mundësi për korrigjim për shkak të qasjes së tyre vetëm në një komunë të caktuar.

Të dhënat për pronarët dhe shfrytëzuesit në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme do të korrigojnë dhe plotësohen, duke e ngritur nivelin e saktësisë së të dhënave. Procesi i korrigjimit do të përmirësojë shfrytëzimin e aplikacioneve online, duke përfshirë nxjerrjen e Certifikatave të pronësisë në eKosova, verifikimin e të dhënave nga Noterët, Përmbauesit Privatë, dhe të tjera.

Përmes rritjes së saktësisë së të dhënave, synohet të rritet kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet dhe produktet kadastrale.

Gjatë këtij procesi janë unifikuar **12370 persona** me të dhëna të shumëfishuara apo **4690 pronarë**.





7.2 Fshirja e hipotekave të skaduara

Në regjistrin e të drejtave pronësore ka pasur një numër të konsiderueshëm të hipotekave me afat të skaduar, por që nuk janë fshirë nga sistemi. Kjo ka ndodhur për arsye të ndryshme qoftë për neglizhencë të hipoteklënësve, qoftë nga informata të mangëta apo edhe për neglizhencë të pengmarrësve. AKK-ja ka marrë vendim për fshirjen e hipotekave të skaduara që kanë qenë të regjistruara në regjistrin e pronave e të cilat më nuk kanë pasur obligime ndaj bankave, përkatësisht institucioneve mikrofinanciare.

AKK-ja fillimisht ka përcjellë listat me këto hipoteka tek secila bankë dhe te secili institucion mikrofinanciar e më pas të njëjtat lista janë filtruar nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare dhe janë konfirmuar se cilat nga hipotekat duhet të fshihen. Me dëgimin e listave nga bankat, AKK ka marrë vendim për fshirjen e tyre.

Numri i hipotekave të fshira të ndara sipas bankave dhe institucioneve mikrofinanciare janë paraqitur në tabelën mëposhtë:

Emri i hipotekmarrësit:	Numri i njësive kadastrale të çregjistruara nga hipotekat
Agjencioni për Financim në Kosovë	11
Banka Ekonomike sh.a.	396
Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.	312
Banka Për Biznes sh.a.	129
Finca Kosovo	45
Institucioni Financiar Jo Bankar Lesna sh.a.	10
Kep Trust	40
Kreditimi Rural I Kosovës sh.p.k.	16
Nlb Banka sh.a.	1111
Pro Credit Bank Sh.a.	1167
Raiffeisen Bank Kosovo j.s.c.	988
Teb sh.a.	1222
Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi a.s - Dega në Kosovë	124
Turkiye Is Bankasi a.s. dega në Kosovë	47
Totali	5618



7.3 Unifikimi i emërtimeve të personave juridik

Në vazhden e korigjimeve të vazhdueshme që kryen AKK për ngritjen e kualitetit të të dhënave në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme, gjatë vitit 2023 krahas unifikimit të të dhënave për personat fizik, është filluar edhe me unifikimin emërtimeve për persona juridik, duke krijuar kështu emërtime unike dhe të sakta për institucionet në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të Paluajtshme.

Nr. rendor	Emërtimi i vjetër	Emërtimi zyrtar/ Institucioni	Nr. fiskal
1	AKP Mitrovicë AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT	Agjencia Kosovare e Privatizimit	600088919
2	A.K.P. AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
3	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT AGJENCIA KOSOVARE4 E PRIVATIZIMIT		
4	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
5	A.K.P. AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
6	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
7	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
8	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
9	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
10	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
11	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
12	A.K.P. AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		
13	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT		



8

KOORDINIMI I PROJEKTEVE

8. KOORDINIMI I PROJEKTEVE

8.1 Projekti për Kadastrin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeo-Hapësinore (REGIP)

Ky projekt do të zbatohet në periudhën pesë (5) vjeçare nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat Komunale Kadastrale (ZKK). Palët e tjera të interesit janë Ministria e Financave (MF), dhe institucionet tjera që janë pjesë e Komitetit ndërministror për administrimin e tokave dhe infrastrukturës kombëtare për informacion hapësinor (IKIH). Institucionet e tjera publike dhe private që prodhojnë dhe menaxhojnë të dhëna gjeohapësinore do të përfshihen sipas nevojës.

Implementimi i projektit REGIP do të ndihmojë Republikën e Kosovës në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të tokës, i cili kryesisht do të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Gjithashtu do të kontribuojë në përmirësimin e mëtutjeshëm të shërbimeve kadastrale dhe përmirësimin e legjisllacionit, duke lehtësuar mbrojtjen dhe sigurinë e të drejtave pronësore dhe krijimin e një mekanizmi të lehtë, dhe të sigurt për transaksionet e pronës së paluajtshme në vend.

Objektivi zhvillimor i projektit është të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe cilësisë të administrimit të tokës, të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

Qëllimi i projektit është të sigurojë mbështetje ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, vazhdimi i punëve të rindërtimit të kadastrit, krijimin e kadastrit të përçojave, zhvillimin e mëtutjeshëm të kadastrit të ndërtesave, shërbimet për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë — SIKTK, Kompletimin e Sistemit të Adresave dhe renovimin e zyrave kadastrale në komunat e mbetura.

Gjithashtu qëllimi i mëtutjeshëm i projektit është të përkrah Teknologjinë Informativë të AKK-së, hartimin dhe zbatimin e Strategjisë për Infrastrukturën të Informacioneve Hapësinore (IKIH) në Kosovë.

Progresi i aktiviteteve sipas komponentëve është siç vijon:

Komponenti A. Politikat, Mbështetja Ligjore dhe Institucionale: Objektivi i këtij komponenti është të ofrojë mbështetje politike, ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Kjo komponentë do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për:

- (a) zhvillimin e një strategjie të përditësuar të AKK-së dhe planit të biznesit për të informuar dhe udhëzuar zhvillimin e ardhshëm të të dhënave dhe shërbimeve kadastrale dhe gjeohapësinore në Kosovë; dhe
- (b) hartimin dhe zbatimin e ligjit të ri për kadastrë.

Në kuadër të këtij komponente është zhvilluar plani strategjik dhe plani i biznesit/veprimit 2021-2025. Për mbështetje të AKK-së rreth hartimit të kornizës ligjore sipas planit të veprimit legjisllativ është angazhuar një Specialist Ligjor. Gjithashtu për mbështetje të Drejtorisë Ligjore të AKK-së, është duke u zhvilluar procedura e prokurimit për angazhimin e dy konsulentëve Ligjor.

Komponenti B. Modernizimi i Kadastrit : Objektivi i këtij komponenti është vazhdimi i modernizimit të kadastrit në Kosovë, i cili kishte filluar në kuadër të projektit paraprak për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër (RECAP). Ky komponent do të mbështes aktivitetet për:

- (a) Rindërtimin e kadastrit në rreth 140 Zona Kadastrale;
- (b) Përmirësimi i cilësisë së të dhënave kadastrale;
- (c) Zhvillimin e kadastrit të përçojave;
- (d) Zhvillimin e regjistrimit të ndërtesave në Komunat e mbetura; dhe
- (e) Renovimin dhe ri-inzhinjerimin e Zyrave Kadastrale Komunale në Komunat Veriore.

- *Rindërtimi i kadastrit në rreth 140 Zona kadastrale*

Ky është projekti kryesor kapital në kuadër të REGIP, dhe për të pasur benefite maksimale për qytetarët në Zonat Kadastrale të parapara në këtë projekt, si dhe për të pasur gjithë përfshirje të akterëve të involvuar në fushën e kadastrit dhe administrimit të tokës në Republikën e Kosovës, me datë 27 Shtator 2021 është mbajtur tryeza e punës me

profesionistë të fushës dhe akterë tjerë institucional, e cila si konkluzion ka nxjerrë nevojën e plotësimit të kornizës ligjore para se të fillohet me këtë projekt. Këto plotësime dhe ndryshime ligjore janë paraparë në Ligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme

- *Shërbimet për korrektimin e të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë — SIKTK*

Qëllimi i projektit është të arrihet kualitet më i lartë i të dhënave kadastrale si dhe rritje e besueshmërisë në të dhëna. Kjo do të krijojë mundësi shumë më të mëdha për hapjen e të dhënave për palë të ndryshme të interesit edhe jashtë institucioneve të kadastrit, gjeodezisë dhe hartografisë, etj.

Paraprakisht janë miratuar plotësimet dhe ndryshimet e Udhëzimit Administrativ MMPH — NR. 11/19 për Ndarjen e Ndërtesës dhe të Pjesës së Ndërtesës si dhe ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës. Është hartuar edhe drafti i Specifikave Teknike të cilat janë aprovuar nga Banka Botërore.

- *Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik*

Qëllimi i projektit është të hartohet dhe implementohet një plan i veprimit të ndërgjegjësimit dhe komunikimit, për të rritur kapacitetin e AKK-së dhe ZKK-ve për të komunikuar me publikun dhe me palët e tjera të interesit. Fillimisht gjatë vitit 2022 është hartuar Plani i Veprimit për Informim Publik. Është hartuar edhe drafti i Specifikave Teknike të cilat janë aprovuar nga Banka Botërore.

- *Blerja e pajisjeve gjeodezike për matje*

Në kuadër të këtij projekti bëhet furnizimi me një Dron të teknologjisë së avancuar për prodhim të të dhënave gjeohapsinore për sipërfaqe jo shumë të mëdha (disa kilometra katrorë) por me nevoja specifike të AKK-së dhe insticioneve tjera shtetërore. Gjithashtu furnizim edhe me pajisje GPS dhe nivelë digjitale për matje saktësisë së lartë të cilat do të përdoren për kontroll të kualitetit për projekte të ndryshme në fushën e matjeve. Kontrata për këtë aktivitet është nënshkruar me 25 shtator 2023 dhe liferimi i pajisjeve është bërë me 21 dhjetor 2023.

- *Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave grafike në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave*

Ky projekt ka për qëllim azhurnimin e të dhënave grafike për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave të cilat kanë qenë të krijuara në formate dhe standarde teknike të cilat nuk janë në përputhshmëri të plotë me avancimet e teknologjisë së SIKTK-HK. Gjithashtu të dhënat për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesave do të konvertohen në përputhshmëri të plotë me udhëzimet si dhe kornizat e punës aktuale për regjistrim dhe mirëmbajtje të dhënave grafike për njësi kadastrale. Projekti është në fazën finale të hartimit të Specifikave Teknike.

- *Staf Profesional për Kadastrin e Përçojave (2 pozita)*

Qëllimi i këtij aktiviteti është evidentimi i shërbimeve nga rrjeti i transportit, rrjeti energjetik (energji elektrike, gaz natyror, energji termike, nafta dhe produktet e naftës etj.), rrjeti i ndërmarrjeve publike (furnizimi me ujë, kanalizimi, ndriçimi publik, etj.), rrjeti i telekomunikimit (telefonja, televizioni kabllor, interneti). Pasi këto rrjete infrastrukturore janë ndërtuar disa kohë më parë, në përgjithësi nuk janë matur dhe inventarizuar sipas standardeve ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj, tani nuk kemi informacione të mjaftueshme dhe të përshtatshme për pozicionin hapësinor dhe standardet me të cilat janë inventarizuar rrjetet e infrastrukturës së përçojave. Për të përkrahur këtë proces janë angazhuar dy Ekspertë Kadastrale të cilët do të ndihmojnë AKK-në në identifikimin e të dhënave që ekzistojnë nëpër institucionet përgjegjëse për këto përçoja.

Komponenti C. Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore:

Objektivi i këtij komponenti është të bëjë investime në sistemet e IT-së dhe investime për të dhënat gjeohapësinore për tregun e tokës dhe pronës në Republikën e Kosovës dhe do të mbështesë zbatimin e strategjive të AKK-së për IT dhe Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH). Ky komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për:

- a) përmirësimin e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë në drejtim të Arkitekturës së Orientuar në Shërbime (SIKTK-AOSH);
- b) Arkivin digjital të AKK-së;
- c) Investimet në IKIH; dhe
- d) Zhvillimin e mëtutjeshëm të rrjetit shtetëror gjeodezik të GPS-it, KOPOS.

- Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës është autoriteti përgjegjës për prodhimin dhe menaxhimin e rilevimit aerofotogrametrik për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Për shkak të zhvillimeve të shpejta në vend, ortofotot e reja prodhohen çdo 3-5 vjet. Ky aktivitet do të mbështesë shfrytëzuesit e të dhënave gjuhëpësinore me ortofoto të reja me kualitet të lartë për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Kontrata për këtë aktivitet është nënshkruar me 06.07.2023. Për shkak të vonësive në marrjen e lejeve të fluturimeve nga organet përgjegjëse, fluturimi për rilevimin aerofotogrametrik të territorit të vendit është shtyrë për në pranverë (prill/maj 2024) dhe rrjedhimisht afati i realizimit të kontratës është zgjatur deri në tetor 2024.

- *Hartimi i Strategjisë dhe planit të veprimit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH)*

Qëllimi i këtij aktiviteti është të përditësohet Strategjia për IKIH që do të sigurojë që informacioni (të dhënat) në lidhje me tokën, ujërat dhe ajrin në Republikën e Kosovës të mbledhet një herë dhe pastaj ato të përdoren nga gjithë shfrytëzuesit në sektorin publik dhe privat. Strategjia për IKIH do të përqendrohet në bashkimin dhe integrimin e informacionit nga shumë burime publike brenda një kornize të qëndrueshme referimi që çon në shpërndarje dhe përdorim shumë më të madh në sektorin publik dhe më gjerë.

Kontrata për hartimin e strategjisë është nënshkruar me 20 mars 2023 dhe drafti final i strategjisë është pranuar me 15 tetor 2023 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Me vendimin Nr. 7471/23, të datës 20.12.2023, të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është emruar Ekipi Punues për Hartimin e Strategjisë Kombëtare të Informacionit Hapësinor, sipas Udhëzimit Administrativ 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit në mënyrë që ky dokument të aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

- *Zgjerimi i qendrës së të dhënave të AKK-së (Hardware+Software)*

Shërbimet dhe sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë të hostuara në Qendrën e të dhënave Primare (në AKK), gjithashtu sistemet kryesore të TI-së replikohen në qendrën e rimëkëmbjes (DRC) e cila gjendet në ndërtesën e Rilindjes. Meqë e gjithë infrastruktura e lartpërmendur është implementuar në vitin 2016 dhe duke pasur parasysh që pajisjet janë liferuar me garancion 3 vjeçar është e domosdoshme zëvendësimi i tyre sa më parë për të mos shkakuar ndërprerje apo humbje të shënimeve. Ky projekt aktualisht është në procedurat finale të prokurimit.

- *Zhvillimi i gjeoportalit të ri*

Qëllimi i këtij aktiviteti është përmirësimi dhe zhvillimi i një gjeoportali të ri. AKK do të menaxhojë këtë gjeoportali, i cili do të përfshijë gjeoportalin për IKIH dhe gjeoportalin ekzistues të AKK-së.

Drafti i specifikave teknike për zhvillimin e gjeoportalit për IKIH është finalizuar dhe aprovuar nga Banka Botërore. Aktualisht është duke u bërë përditësimi i këtyre specifikave për të përfshirë edhe përditësimin e gjeoportalit aktual shtetëror.

- *Avancimi i Sistemeve Kadastrale*

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar një sistem të avancuar për regjistrimin e pronës së paluajtshme në vend, "Sistemi Informativ Kadastral i Tokës së Kosovës" (SIKTK). Ky sistem pritet të avancohet me module të reja për shërbime sa më cilësore, të sakta, transparente dhe të shpejta për qytetarët e Republikës së Kosovës. Sistemi është krijuar për të ndërvepruar me sistemet e institucioneve dhe grupeve të tjera të interesit për qasje në të dhënat kadastrale. Ky projekt pritet të fillojë në pjesën e parë të vitit 2024.

- *Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave për territorin e Republikës së Kosovës*

Një proces shumë i rëndësishëm i Sistemit të Adresave është plotësimi i regjistrimit digjital të adresave përmes përditësimit të të dhënave të adresave në terren.

Projekti pritet të përfundojë në fillim të vitit 2024. Janë mbledhur të dhënat e adresave nga terreni dhe janë futur këto të dhëna në Sistemin e Adresave (ARIS).

Në katër Komunat Veriore të Republikës së Kosovës dhe Komunën e Parteshit projekti deri më tani nuk ka mundur të fillojë për shkak të mosbashkëpunimit të këtyre Komunave me AKK-në.

- *Matja e rrugëve të reja në terren për Sistemin e Adresave*

Qëllimi i këtij projekti është grumbullimi i të dhënave për rrugët përmes matjeve me GPS, aty ku mungojnë të dhënat. Të dhënat e referuara do të jenë të dhënat e rrugëve dhe skicat e rrugëve. Ky projekt është përfunduar në muajin gusht 2023, ku afër 800 km rrugë të reja janë matur dhe përditësuar në ARIS.

- *Finalizimi i sistemit të adresave - Tabelat e rrugëve dhe numrat e hyrjeve të objekteve*

Me përfundimin e Sistemit të Adresave, një nga standardet Evropiane për integrimin në BE do të përmbushet, i cili parashikon sigurimin / publikimin e të dhënave gjeo-hapësinore, sigurimin e shërbimeve më të shpejta dhe funksionale për qytetarë në shumë zona, mundëson lidhjen e bazës së të dhënave me adresat ndërmjet institucioneve të ndryshme përfutuese, etj. Projekti pritet të fillojë në pjesën e parë të vitit 2024.

- *Lidhja e sistemit të adresave me regjistrin civil*

Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë AKK-në në plotësimin, azhurnimin e të dhënave në regjistrin kadastral dhe mbështetjen e komunave përmes ndërlidhjes ndërmjet Sistemit të Informacionit të Regjistrimit të Adresave (ARIS), Sistemit të Regjistrimit të Gjendjes Civile (CSRS) dhe Informacionit të Kadastrit të Tokës në Kosovë (SIKTK).

Sipas iniciativës së Zyres së Kryeministrit dhe me përkrahje të GIZ-it, në tetor 2023 është përfunduar pilot projekti për lidhjen e sistemit të adresave me regjistrin civil në Komunat Mitrovicë e Jugut dhe Istog. Agjencia Kadastrale e Kosovës me 10.11.2023 ka formuar grupin punues për hartimin e specifikave teknike për implementimin e këtij projekti në Komunat tjera dhe drafti fillestar i këtyre specifikave është hartuar..

- *Angazhimi i katër (4) Specialistëve të GIS-it për Sistemin e Adresave*

Qëllimi i këtij aktiviteti është angazhimi i katër (4) specialistëve vendor të GIS-it për të mbështetur Njësinë e Adresave në AKK, për të implementuar aktivitetet e Finalizimit të Sistemit të Adresave. Këta specialistë janë angazhuar nga mesi i vitit 2022, dhe është plotësuar me një specialist në tetor 2023, pas dorëheqjes së njërit prej tyre.

- *Zëvendësimi dhe përmirësimi i pajisjeve të sistemit KOPOS, duke përfshirë softuerin, licencat dhe pajisjet*

Meqë Sistemi KOPOS është themeluar në vitin 2012, dhe artikujt e softuerit dhe pajisjeve brenda sistemit nuk janë më nën periudhën e garancisë dhe mirëmbajtjes, është shfaqur nevoja për qëndrueshmërinë e sistemit dhe ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve cilësore për rreth 190 përdorues aktivë të regjistruar në KOPOS. Ky aktivitet është finalizuar në fund të vitit 2022.

- *Zhvillimi i UEB faqes së AKK-së*

Ueb faqja e AKK-së, ka për qëllim të jetë kanali kryesor i komunikimit me audiencën. E gjithë përmbajtja kryesore siç është legjislacioni, projektet dhe produktet me çmime, literatura profesionale, FAQ, qasja në dokumente publike, tenderë, etj., paraqitet në këtë faqe. Në anën tjetër, është një faqe e gjeoportalit, ku janë paraqitur vetëm të dhëna gjeografike. Projekti ka përfunduar në vitin 2022 dhe adresa e ueb faqes së zhvilluar është <https://akk.rks-gov.net>. Periudha e mirëmbajtjes është 3 vjet.

Komponenti D. Menaxhimi i Projektit, Ndërtimi i Kapaciteteve, Informimi Publik dhe Monitorimi dhe Vlerësimi

Qëllimi i këtij komponenti është të sigurojë zbatimin e plotë të Projektit REGIP. Ky komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për:

- njësinë e zbatimit të projektit (PIU) dhe koordinimin e donatorëve;
- monitorimin dhe vlerësimin;
- anketat e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet kadastrale, dhe
- Informimi i publikut dhe mekanizmi i dëmshpërblimit (GRM).

- *Hulumtimi i kënaqshmërisë së klientëve me shërbimet kadastrale*

Qëllimi i këtij hulumtimi të kënaqshmërisë së klientëve me shërbimet kadastrale ka dy objektiva kryesorë: cilësinë dhe disponueshmërinë e administrimit të tokës dhe të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve. Në mënyrë të ngjashme, disponueshmëria e administrimit të tokës dhe të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve do të matet përmes qasjes më të madhe dhe transparencës së këtyre të dhënave dhe shërbimeve. Gjithashtu do të vlerësojë cilësinë, efikasitetin dhe efektivitetin e administrimit të tokës dhe pasurive të paluajtshme të të dhënave dhe shërbimeve të ofruara nga AKK-ja dhe ZKK-të dhe ato organizata profesionale të përfshira në aktivitetin e tregut të pasurive të paluajtshme. Projekti është përfunduar në fund të vitit 2022.

- *Sistemi operacional për Monitorim dhe Vlerësim*

Objektivi i përgjithshëm është një studim fillestar për krijimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit operativ për projektin REGIP dhe ndihmën për të hartuar një studim bazë bazuar në indikatorët (treguesit) përkatës. Qëllimi është t'i sigurojë AKK / NjIP bazë për të monitoruar në mënyrë efektive, progresin dhe arritjet e projektit, dhe për të siguruar vlerësime në fund të projektit me informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar suksesin e projektit.

Projekti është finalizuar në vitin 2022, dhe ky sistem shërben për të raportuar lidhur me progresin në përmbushjen e indikatorëve të projektit REGIP në baza gjashtë mujore.

- *Angazhimi i stafit profesional në kuadër të NJIP-REGIP*

Njësia Implementuese e Projektit REGIP është kompletuar me stafin e nevojshëm profesional për të ndihmuar implementimin e projektit.

8.2 Bashkëpunimi me USAID

Aktiviteti i USAID-it Qeverisja e Pronës është një aktivitet pesëvjeçar që synon të përmirësojë sistemin e të drejtave pronësore në Kosovë për të reduktuar korrupsionin, rritur fuqizimin e grave në sistemin e të drejtave formale të pronës dhe investimet në

pronën e paluajtshme. Aktiviteti zhvillohet në partneritet me shoqërinë civile, sektorin privat dhe akterë tjerë që ndikojnë në avancimin e zhvillimit ekonomik dhe demokratik në Kosovë.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka pasur një bashkëpunim të mirë me këtë projekt, i cili ka mbështetur AKK-në në organizimin e dy takimeve të Komitetit Ndërmëtor për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinor, mbajtjen e takimit me Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës, si dhe mbajtjen e punësive të ndryshme dhe Komitetin e Praktikave të mira.

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur gjithsej **7 punëtori** dhe **6 takime** të Komitetit për praktika të mira në kuadër të Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës.

Vizita e Drejtorit të Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje të USAID-it në AKK

Agjencia Kadastrale të Kosovës me 12 tetor 2023 ka pritur në takim Drejtorin e Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje të USAID-it, z. Noel Bauer me bashkëpunëtorë. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësuesit e projektit të USAID për Qeverisje të Pronës. Të pranishmit janë informuar nga AKK lidhur me progresin e arritur në AKK, reformat ligjore, sfidat dhe objektivat për të ardhmen, gjersa palët konfirmuan bashkëpunimin e ndërsjellë në nivel të lartë, si dhe u dakorduan për të vazhduar këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen. Një ndër temat e këtij takimi ishte edhe kërkesa nga ana e AKK-së për financimin e përditësimit të Gjeoportalit aktual shtetëror nga projekti për Qeverisje të Pronës.



Vizita e Drejtorit të Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje të USAID në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

8.3 Bashkëpunimi me GIZ-in

GIZ-i ka mbështetur realizimin e pilot projektit për lidhjen e Sistemit të adresave me Regjistrin Civil në Komunitetet Istog dhe Mitrovicë e Jugut. Rezultatet e këtij pilot projekti do të shërbejnë për të zhvilluar projektin e lidhjes së sistemit të adresave me regjistrin civil në të gjitha Komunitetet tjera, projekt ky që mbështetet nga projekti REGIP i Bankës Botërore.

Gjithashtu GIZ në bashkëpunim me AKK-në është duke zhvilluar aplikacionin e digjitalizimit të procesit të aplikimit të gjeodetëve për licenca dhe në përgjithësi thjeshtimin e procedurave administrative.

8.4 Mbështetja e Qeverisë Holandeze — Projekti Spatial II për Ballkanin Perëndimor

Nën organizimin e projektit regjional SPTIAL II është realizuar vizita studimore në Holandë për delegacionin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK). Nikoqire e kësaj vizite ishte “Agjencia e regjistrimit të pronës, kadastrit dhe hartografisë” e Holandës.

Vizita Studimore u realizua në periudhën 26-30 Mars 2023, ku nga AKK morën pjesë 4 (katër) zyrtarë/specialistë të fushave përkatëse.

Temat që u trajtuan në këtë vizitë studimore ishin: e-Qeverisja Holandeze dhe ndërlidhja e saj me Infrastrukturën Kombëtare të të Dhënave Hapësinore, Puna e Gjeoportalit PDOK (Platformë për Shpërndarjen e të Dhënave Hapësinore), Sistemi i Regjistrave në Holandë, Produktet dhe Shërbimet, Vlerësimi Masiv (rrugëtimi holandez), Regjistri për Taksimin e Pasurive të Paluajtshme. U vizituan edhe Qendra për mbledhjen e taksave komunale Tribut e cila merret me mbledhjen e taksave për komunitet në rrethinën e Apeldoornit, Zyra Kadastrale në Amsterdam ku u prezantua Regjistri për Adresa dhe Ndërtesa si dhe Tregu i Tokave dhe Vlerësimi Masiv. Gjithashtu u vizitua edhe Këshilli Holandez për Vlerësimin e Pasurisë së Paluajtshme në Hagë.

Gjithashtu në kuadër të përkrahjes për AKK-në janë mbajtur disa takime online për të ndihmuar AKK-në lidhur me hartimin e specifikave teknike për korrigjimin e të dhënave në SIKTK dhe zhvillimin e Gjeoportalit për IKIH. Përfaqësuesit e Kadastrit Holandez kanë

kontribuar edhe me pjesëmarrjen e tyre të rregullta në takimet e Komitetit ndërminterior për administrimin e tokës dhe Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Hapësinor, si dhe takimet e Komitetit koordinues të donatorëve në AKK.



Vizitë në Agjencinë e regjistrimit të pronës, kadastrit dhe hartografisë në Holandë

8.5 Bashkëpunimi me UN HABITAT-in

Bashkëpunimi me UN Habitat-in kryesisht ka qenë i orientuar në lehtësimin funksionalizimit të Zyrave Komunale Kadastrale të Komunave Veriore: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, duke ndihmuar në organizimin e takimeve me këto Komuna.

8.6 Bashkëpunimi me OSBE-në

OSBE është e fokusuar në zbatimin e ligjit dhe regjistrimin e të drejtave pronësore. Ambasadori i OSBE është zotuar që do ofrojë mbështetje në aktivitete tjera që lidhen me kadastrë, gjithashtu implementimin e ligjit dhe promovimin e tij, etj.

Bashkëpunimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës me OSBE-në ndërlidhet me zbatimin e Strategjisë për të drejta pronësore.

Aktualisht OSBE-ja përkrahë AKK-në me dy praktikantë në Drejtorinë Ligjore.



**ADMINISTRIMI I
INFRASTRUKTURËS SË
TEKNOLOGJISË
SË INFORMACIONIT (TI)**

9. ADMINISTRIMI I INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI)

AKK menaxhon, administron dhe monitoron në baza ditore infrastrukturën në qendrën e të dhënave primare dhe qendrën sekondare (DRC), ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm profesional për të siguruar shërbime të pandërprera për të gjithë përdoruesit e regjistruar në domenin kompjuterik të AKK-së si dhe për ata të internetit që shfrytëzojnë shërbime të hostuara në qendrën e saj të të dhënave. Gjithashtu administron sigurinë e sistemit të TI-së në të gjitha nivelet dhe për të gjithë përdoruesit e regjistruar në domenin e AKK-së.

9.1 Mirëmbajtja e dhomës së serverëve

Mirëmbajtja e dhomës së serverëve ka vazhduar edhe në vitin 2023. Kontrata e fundit dy vjeçare e emërtuar “Mirëmbajtje e sistemit TI (Klimë dhe UPS, në dhomën e serverëve) të AKK-së” është duke vazhduar nga Korriku i vitit 2022. Servisimet e rregullta periodike (çdo 3 muaj) janë duke vazhduar deri në fund të kontratës në Gusht të vitit 2024.

9.2 Aktivitete rreth sigurisë

Ngritja e versionit të Sophos Enterprise Console

Në kohën kur siguria kibernetike po merr vëmendje të madhe, kjo si shkak i shtimit të vazhdueshëm të rreziqeve cilat ekspozojnë dhe eksploatojnë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, ASHI ka kaluar në konzollën CLOUD të antivirusit SOPHOS, e quajtur Sophos Central. Sophos Central është platformë e sigurisë së informacionit e cila ka integruar teknologjitë si Inteligjenca Artificiale, Deep Data Analytics, Sistem të automatizuar të reagimit në rast incidenti, çka mundësojnë rritjen eksponenciale të nivelit të sigurisë dhe uljen deri në 90% të numrit të incidenteve të sigurisë, kohës së identifikimit të problemeve dhe rrit eficiencën në punë duke eliminuar aktivitetet e përditshme administrative rreth sigurisë kibernetike. AKK ka përgatitur infrastrukturën e nevojshme për instalimin e konzollës së re, paralelisht me ekzistuesen. Janë bërë të gjitha konfigurimet e duhura për të mundësuar replikimin mes dy konzollave, kështu duke i bartur të gjithë

shfrytëzuesit dhe pajisjet fundore në konzollën e re. Pas kalimit në konzollën e re është konfiguruar sistemi i automatizuar i instalimit përmes skriptave, të versionit të ri, në kompjuterë dhe serverë. Në kompjuterët që ka qenë e pa mundur teknikisht instalimi automatik është ndërhyrë veç e veç. Versioni i fundit i antivirusit tani është i instaluar në **50** server dhe **420** kompjuterë.

Mbrojtja nga RANSOMWARE

Për çështjet e sigurisë kibernetike, AKK vazhdimisht hulumton në internet për të mbledhur informacion kështu duke qenë në hap me kohën për ndonjë rrezik të ri që mund të i kanoset infrastrukturës tonë. Pas raportimeve të VMware për sulme të mundshme kibernetike, të cilat realizoheshin nga hakerët duke shfrytëzuar SLP servisin për të injektuar virusin RANSOMWARE, ky servis është de aktivizuar në 13 server fizik (ESXi). Aktivizimi i këtij servisi nuk paraqet ndonjë problem për AKK-në, pasi që ky servis shfrytëzohet vetëm për komunikim me shërbimin e monitorimit të infrastrukturës virtuale vROP Manager.

Certifikatat e sigurisë

Me qëllim të rritjes së sigurisë dhe përcjelljes së praktikave më të mira për funksionimin e sistemeve elektronike të bazuara në web, është bërë kalimi në protokollin e komunikimit HTTPS nga HTTP në shërbimet e SIKTK-SOA, SIKTK-API dhe UCWSS. Pas përgatitjes së infrastrukturës, për të mundësuar komunikimin në këtë protokoll, është bërë edhe ri drejtimi i trafikut nga jashtë-brenda vetëm në HTTPS. Gjithashtu gjatë vitit bëhet edhe monitorimi i skadimit të certifikatave të sigurisë, në shërbimet që kanë qenë të publikuara në HTTPS, dhe është kërkuar nga ASHI gjenerimi i certifikatave të reja duke parandaluar dështimin e shërbimeve.

Penetration TEST

Gjatë gjithë vitit, sa herë që ASHI ka kërkuar përkrahje, janë asistuar në testime të sigurisë apo PENETRATION TEST. Këtyre testimeve i nënshtrohen sistemet elektronike të qasshme në internet apo shërbime publike. Këto testime simulojnë sulme kibernetike kundrejt sistemeve kompjuterike, rrjetave dhe aplikacioneve me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta të sigurisë të cilat mund të shfrytëzohen nga hakerë të vërtet me qëllime

të këqija. Raportet e dala nga këto testime janë trajtuar me kujdes dhe çdo këshillë eventuale është aplikuar me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë.

Azhurnimet

Sistemet Operative të Domain Controlers ishin të vjetruara dhe jashtë përkrahjes nga Microsoft. Si një vegël e fuqishme e mbrojtjes në aspektin kibernetikë fokus i veçantë i kushtohet edhe azhurnimit të sistemeve operative në infrastrukturën tonë. Kështu tre serverët (Domain Kontrollorët) janë azhurnuar në sistemin operativ të fundit, ku pastaj janë realizuar edhe të gjitha konfigurimet dhe testimet e nevojshme. Pas testimeve të suksesshme këta tre serverë kanë kaluar në ambientet reale dhe 3 tjerët janë neutralizuar.

Gjithashtu edhe sistemi operativ i shërbimit të sistemit automatik të instalimit të azhurnimeve (WSUS) është ngritur në versionin e fundit. Me këtë azhurnim është arritur që shërbimi të ketë versionet e fundit të azhurnimeve nga Microsoft dhe ato ti distribuoj dhe instaloj në kompjuterët dhe serverët tanë. Azhurnimet e sistemeve operative vazhdimisht i bëhen edhe pajisjeve tjera që përdorin sisteme operative tjera, si janë Storage dhe pajisjet e rrjetës.

Siguria fizike

Në aspektin e sigurisë fizike në këtë vit DTI ka instaluar sensor të monitorimit të temperaturës në dhomën e serverëve në kohë reale. Kjo do na mundësoj që pa varësisht lokacionit ku gjendemi të kemi të dhëna në kohë reale rreth temperaturës në dhomë.



9.3 Monitorimi

AKK-ja bënë monitorim të vazhdueshëm të infrastrukturës së TI-së në qendrën primare dhe sekondare (DRC). E gjithë infrastruktura e TI-së përmes sistemeve siç janë Solarwinds, vRealize Operations Manager, ADAudit Plus, UptimeRobot dhe pajisje me sistem të vetin monitorues, monitorohen 24/7 dhe notifikojnë me email stafin e TI-së për ndonjë problem që mund të paraqitet në pajisje\sisitem, tentim për ndonjë veprim të dyshuar që mund të cenoj sigurinë e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike dhe kalkuloohen trendet e shfrytëzimit të resurseve kompjuterike në qendrat e të dhënave. Në tabelë i gjeni të paraqitura ndryshimet në vlerat e shfrytëzuara, për periudhën 12 mujore të këtij viti, për resurset kompjuterike CPU, RAM dhe Storage në Qendrën e të dhënave të AKK-së:

Resursi kompjuterik	Janar	Dhjetor
CPU	129 Ghz	146 Ghz
RAM	1.4 TB	1.45 TB
Storage	103 TB	104 TB

Infrastruktura fizike e teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve digjitale, që ofrohen nga AKK, janë tejet komplekse dhe po zgjerohen vazhdimisht. Monitorimi i tyre është i pamundur pa ndihmën e platformave specifike të avancuara të monitorimit. Për këtë arsye, është hulumtuar për një zgjidhje të nevojshme dhe praktike, ku pastaj edhe është përgatitur specifikimi i nevojave të monitorimit. Gjatë këtij viti është marrë, instaluar dhe konfiguruar nga vetë stafi platforma OPManager Plus. Kjo platformë mundëson monitorimin e WEB shërbimeve, databazave, infrastrukturës së rrjetave të komunikimit, platformës së virtualizimit dhe stroage. Përveç monitorimit kjo platformë mundëson edhe krijimin e politikave të notifikimit automatik përmes konfigurimit të alarmeve. Tani na është mundësuar një pamje gjithëpërfshirëse dhe më e thjeshtë e një infrastrukture shumë komplekse.

Pas nxjerrjes së raporteve nga sistemet monitoruese del që për vitin 2023 e gjithë infrastruktura e TI-së ka qenë "UPTIME" 99.40%, ndërsa të gjitha aplikacionet e AKK-së kanë qenë të qasshme nga rrjeti i brendshëm 99.92% ndërsa nga rrjeti i jashtëm (interneti) 99.5 %.

9.4 Testimi i ngritjes së shërbimeve në DRC

Plani i rimëkëmbjes në qendrën sekondare (DRC) parasheh që këto procedura të ndjeken dhe testohen çdo 6 muaj, respektivisht në qershor dhe nëntor të çdo viti.

Testimi i rregullt 6 mujor është bërë në qershor dhe nëntor të këtij viti, ku janë ngritë shërbimet në qendrën sekondare të të dhënave duke simuluar gjendjen e reale e një “Disaster Recovery”. Përmes SRM është inicuar Disaster Recovery ku virtual makinat e replikuara ngritën në qendrën e dytë në një rrjet virtual të izoluar me qëllim të testimit të funksionimit të kalimit nga qendra e parë në të dytën dhe pa shkaktuar pengesa në ambientin real. Testimi ka dalë të jetë i suksesshëm dhe virtual makinat janë kthyer përsëri në gjendjen normale në qendrën e parë të të dhënave.

9.5 Administrimi i Sistemeve të Informacionit (SI), databazave dhe qasjeve

Një prej aktiviteteve të rëndësishme të AKK-së është edhe administrimi i Sistemeve të Informacioneve (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, KOPOS, Intranet, Sistemi i faturimit, Gjeoportali, etj.) në kuptimin e përgatitjeve të ambienteve për testime, trajnime dhe ambienteve reale, sipas kërkesave dhe nevojave. Pjesë e rëndësishme e administrimit të SI është edhe administrimi i databazave, qasjeve, zhvillimi i skripteve TSQL për nxjerrjen e raporteve, statistikave për qëllime të hulumtimit ose të kontrollës së kualitetit të të dhënave kadastrale dhe të tjera në nivel të databazave.

Për aspekte të zhvillimeve të reja dhe mirëmbajtjes së SI (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, Gjeoportali), AKK ka angazhuar OE.

10

SHËRBIMET DHE
OFRIMI I TË DHËNAVE

10.1 Shpronësimi

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka ofruar përkrahje për institucione të ndryshme në hartimin e elaboreve të shpronësimit dhe zgjidhjen e problemeve të paraqitura në disa projekte të rëndësishme.

Përgatitja e elaboreve të shpronësimit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për projekte publike në komunat dhe objektet e kërkuara nga institucione të tjera ka qenë njëri nga aktivitetet e këtij viti.

Në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Doganës së Kosovës, Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A., etj., Agjencia Kadastrale e Kosovës ka përgatitur një sërë elaboreve të shpronësimit për projekte infrastrukturore të interesit publik.

Disa nga elaboretet e shpronësimit të trajtuara nga AKK-ja gjatë këtij viti janë:

Elaborati: "Projekte Infrastrukturore për Interes Publik"

- Komuna Leposaviq, Zona Kadastrale: Bistricë e Shalës;
- Komuna Zubin Potok, Zonat Kadastrale: Jasenovik i Epërm, Zubin Potok, Bërnjak dhe Banjë;
- Komuna Leposaviq, Zonat Kadastrale: Bistricë, Bërnjak, Breg i Madh dhe Koshotovë;
- Komuna Suharekë, Zona Kadastrale: Suharekë (sipas kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes).

- Gjithsej janë përgatitur 2 elabore të shpronësimit në kuadër të projektit.

Elaborati: "Programi për Menaxhimin e Mbeturave të Ngurta II - IV Kosovë"

- Ferizaj: dy zona kadastrale;
- Gjilan: dy zona kadastrale;
- Podujevë: një zonë kadastrale;
- Prishtinë: tre zona kadastrale;
- Prizren: një zonë kadastrale.

- Elaborati i shpronësimit është kryer sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë - Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.

Elaborati: Qendrat e trashëgimisë kulturore ZK Graçanicë dhe Dresnik

- Elaborati i shpronësimit është kryer sipas kërkesës së Ministrisë së Kulturës.

Elaborati: Terminalet Doganore Dheu i Bardhë, Merdare dhe Hani i Elezit

- Elaborati i shpronësimit është kryer sipas kërkesës së Doganës së Kosovës.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ka përfunduar përgatitjen e elaboretit të Shpronësimit për Terminalet Doganore Dheu i Bardhë, Merdare dhe Hani i Elezit, në përputhje me kërkesën e Doganës së Kosovës. Matjet gjeodezike në terren janë përfunduar në dy lokacionet e përmendura dhe është kryer përpunimi i të dhënave.

Elaborati: "Qendrën Kombëtare të Xhudos"

- Elaborati i shpronësimit është kryer sipas kërkesës së Ministrisë së Kulturës

Elaborati: Ndërtimi i rrugës Prishtinë-Podujevë

- AKK-ja ka bashkëpunuar ngushtë me Ministriën e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në zgjidhjen e çështjeve të shpronësimit që kanë dalë gjatë procesit të hartimit të elaboretit të shpronësimit.

Elaborati: Kyçjen e Vitisë në autostradë

- Kjo ka përfshirë identifikimin e pronave të nevojshme për këtë projekt dhe zgjidhjen e çështjeve të shpronësimit që kanë dalë gjatë hartimit të elaboreve.

Elaborati: Realizimi i impiantit fotovoltaik me kapacitet 100MW në deponinë e hirit TC Kosova A,

- AKK-ja ka punuar me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për të hartuar elabore të shpronësimit dhe për të zgjidhur çështjet e shpronësimit në lidhje me këtë projekt.

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka ofruar përkrahje për institucione të tjera duke përgaditur të dhëna kadastrale për nevoja të shpronësimit.



Gjendja para regjistrimit të elaboratit të shpronësimit në SIKTK




Gjendja pas regjistrimit të elaboratit të shpronësimit në SIKTK

10.2 Statistika nga SIKTK


Agjencia Kadastrale e Kosovës menaxhon dhe mirëmban regjistrin mbi të drejtat e pronës së paluajtshme. Përmes Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokave në Kosovë-SIKTK, nga ZKK-të dhe AKK gjatë vitit 2023 janë aprovuar gjithsejtë 84,463 lëndë dhe janë lëshuar 141,113 certifikata, prej të cilave 7769 janë certifikata/vërtetim për mosposedim të pronës. Disa nga këto statistika janë të paraqitura në vazhdim.

Statistika për numrin e kërkesave nga institucionet




- Në vitin 2023 nga SIKTK për gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë lëshuar gjithsej **133,344 Certifikata të pronësisë**, ku prinë **Prishtina me 16,462** certifikata të pronësisë të lëshuara, ndërsa e fundit është **Zveçani me 95 certifikata** të pronësisë të lëshuara.
- Në nivel të Republikës së Kosovës janë aprovuar gjithsejtë **23,963 lëndë shitblerje**, ku numri më i madh i tyre ka qenë në Prishtinë me **4773 lëndë**.
- Janë aprovuar **6454 lëndë të trashëgimisë**, poashtu **12,545 lëndë ndarje** parcele dhe **4958 lëndë bashkim** i parcelave.

Numri i lëndëve sipas llojit



Numri i lëndëve sipas Komunes



Numri i lëndëve periudhave kohore



Subjekti juridik/Personi fizik	Numri i kërkesave
Policia e Kosovës	102
ILECU	8
Agjencia Kundër Korrupsionit	3
MMPHI	1
AKI	9
Zyra për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor KGJK-së.	2
Gjykata Themelore Prishtinë	13
Ministria e Kulturës	1
Përmbartuesi privat	34
Gjykata Themelore Mitrovicë	4
AKP	10
Avokatura shtetërore	1
Gjykata Themelore Pejë	3
Gjykata Themelore Prizren	3
Prokuroria Themelore Pejë	2
MMPHI	15
Dogana	1
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave	1
Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës	2
ATK	4
N.P.H. Ibër Lepenci	1
Unmiku	1
Totali i kërkesave	221

Trajtimi i kërkesave si organ i shkallës së dytë	200
Kërkesa nga institucionet tjera	221
Kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kopje të planit	379
Trajtimi i kërkesave si organ i shkallës së parë (komunat veriore)	50
Gjithsej	850

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve kadastrale për qytetarët e këtyre tri komunave, AKK duke u bazuar në Ligjin për kadastër është duke pranuar kërkesat e qytetarëve, dhe për të njëjtat lëshon dokumente kadastrale dhe pronësore si dhe bëhen azhurnimet e të dhënave në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronat të Paluajtshme.

Numri i certifikatave të lëshuara për 5 vite			
Vitet	Leposaviq	Zubin Potok	Zveçan
2019	151	88	71
2020	139	59	56
2021	151	77	98
2022	85	41	73

Lista e kopjeve të planit të lëshuara për 5 vite			
Vitet	Leposaviq	Zubin Potok	Zveçan
2019	113	77	57
2020	81	40	41
2021	77	37	78
2022	48	24	41
2023	255	320	128

Ndërsa janë azhurnuar në SIKTK: Leposaviq **5 lëndë**, Zveçan **32 lëndë** dhe Zubin Potok **8 lëndë**

10.3 Statistika nga shkëmbimi i të dhënave me institucionet e jashtme

Agjencia Kadastrale e Kosovës edhe gjatë këtij viti ka bërë disa marrëveshje me institucione për shkëmbimin e të dhënave Kadastrale përmes ueb servise të zhvilluara në SIKTK-T. Institucionet të cilat konsumojnë shërbime janë: Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Oda Përmbauesve Private, Departamenti i Tatimit në Pronë, Bankat, Institucionet Microfinanciare, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Oda e Noterëve të Kosovës, Këshilli Prokurorial, Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës, Gjeodetët Privat të Licencuar, Policia e Kosovës si dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Departamenti i Tatimit në Pronë, Bankat dhe Institucionet Microfinanciare, Administrata Tatimore e Kosovës konsumojnë shërbimet tona përmes ueb serviseve, ndërsa institucionet tjera konsumojnë shërbimin përmes GUI aplikacionit.

Për institucionet që marrin shërbim përmes GUI aplikacionit, AKK organizon trajnim për shfrytëzimin e tij, fillimisht në ambientin testues ku krijohen shfrytëzues sipas nevojës së institucionit për një periudhë të caktuar e më pastaj kjo lidhje ndërpritet dhe vazhdohet konsumimi i tyre në ambientin real. AKK në vazhdimësi bënë përkrahje të shfrytëzuesve të të gjitha institucioneve deri në përvetësimin e sistemit nga ana e tyre.

Deri më tani përmes GUI aplikacionit tonë marrin shërbime rreth 298 shfrytëzues nga të gjitha institucionet e lartcekura. Ndërsa kanë filluar konsumimin e shërbimeve kadastrale përmes GUI aplikacionit nga sistemi real edhe 151 Gjeodetë privatë të Licencuar nga AKK-ja.

Po ashtu edhe gjatë këtij viti Departamenti i Tatimit në Pronë me datën 30 Nëntor përmes ueb servisit të AKK-së ka konsumuar të gjitha të dhënat kadastrale me qëllim të faturimit të qytetarëve për tatimin në pronë.

Statistikat për periudhën Janar-Nëntor 2023 për shërbimet nga platforma Online (GUI forme) janë si në vijim:

- Administrata Tatimore e Kosovës në sistemin online ka krijuar 223 lëndë;
- Përmbauesit në sistemin online kanë krijuar 153 lëndë;
- Noterët në sistemin online kanë krijuar 1176 lëndë;
- AKP në sistemin online ka krijuar 217 lëndë;
- Gjodetët Privat në sistemin online kanë krijuar 1150 lëndë;
- Departamenti i Tatimit në Pronë në sistemin online ka krijuar 352 lëndë.

Statistikat për periudhën Janar-Nëntor 2023 përmes sistemit online për regjistrimin, modifikimin si dhe fshirjen e hipotekave janë si në vijim:

- Lëndë 'Regjistrim i hipotekës' janë 3076 lëndë;
- Lëndë 'Modifikim i hipotekës' janë 121 lëndë;
- Lëndë 'Fshirje e hipotekës' janë 2319 lëndë.

10.4 Statistika nga DL

Drejtoria Ligjore, gjatë vitit 2023 ka pranuar gjithsej 982 lëndë, duke përfshirë ankesa kundër vendimeve të ZKK-ve, kërkesa për sqarim nga vetë ZKK-të, kërkesa të parashtruara si nivel i shkallës parë në procedurë administrative për ZKK Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, si dhe lëndë të cilat vijnë nga organet tjera: Gjykatat, Policia dhe Prokuroria.

Drejtoria Ligjore, pas shqyrtimit të të gjitha lëndëve brenda afatit të përcaktuar ligjor ka dhënë përgjigje, përkatësisht ka nxjerrë vendime apo aktin juridik që ka qenë i paraparë sipas dispozitave ligjore dhe fazes së procedurës që është zhvilluar.

Duke ju referuar statistikave të gjithmbarshme të nxjerra nga Drejtoria Ligjore, lëndët për të cilat AKK ka zhvilluar procedurën administrative si organ i shkallës së dytë ka qenë 940, duke dhënë përgjigje në të gjitha këtë lëndë, ku nga të gjitha për 129 lëndë është vendosur të aprovohen, 137 janë refuzuar me vendim përfundimtar, 343 lëndë janë vendosur me njoftim për ZKK apo palët ankuese, rrjedhimisht janë rekomanduar për procedurë në organet kompetente, apo ZKK-së i është rekomanduar procedura e nevojshme për përfundimin e lëndëve për të cilat ka pasur kërkesa të tilla, 62 lëndëve në

procedure gjyqësore i është dhënë përgjigja në padi, 110 ftesa për seancë kemi pranuar në shumicën e tyre kanë prezantuar zyrtar të zyrës ligjore, 7 lëndë janë pezulluar për arsye të zhvillimit të procedurave tjera ligjore (administrative apo gjyqësore) që paraqesin shkak për pezullim, 65 lëndë janë dërguar në kompetencë, qoftë brenda për brenda AKK-së (Drejtoratin e RDPP-së) apo edhe në insitucionet tjera shtetërore. AKK si organ i qëndor, gjithashtu është përgjigjur në 54 raste të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendeve Komunale.

Si shkallë e dytë									
Aprovim	Refuzim	Heshtje administrative	Njoftim-përgjigje ne kerkese/ ankese	Përgjigje në padi	Seanca	Pezullim i procedurës	Dërgim në kompetencë	Vlerësim i ligjshmërisë së akteve komunale	TOTALI
129	137	37	343	62	110	07	62	54	982

Drejtoria Ligjore në mesin e aktiviteteve tjera, ka shqyrtuar 42 lëndë, si organ i shkallës pare për ZKK Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, prej tyre 39 lëndë janë aprovuar dhe regjistruar në RDPP, 2 lëndë janë refuzuar.

Si shkallë e parë (Komuna Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq)	
Aprovim	Refuzim
39	2

10.5 Statistika nga Sistemi i Pozicionimit Satelitor në Kosovë — KOPOS

Rrjeti permanent i pozicionimit në Republikën e Kosovës (KOPOS) mbulon tërë territorin e vendit në përcaktimin e pozitës me një saktësi centimetrike në rrafshin horizontal dhe vertikal, bazuar në sistemin zyrtar referent KosovaRef01. Në vitin 2023 janë regjistruar 20 përdorues të rinj të shërbimeve të KOPOS-it dhe kanë vazhduar abonimin 126 shfrytëzues. Gjatë vitit, shërbimet e KOPOS-it janë përdorur nga gjithsej 176 shfrytëzues. Përdorimi mesatar ditor i shërbimeve të KOPOS-it është rreth 82 orë në ditë dhe mesatarisht 2450 orë në muaj, ndërsa numri i shfrytëzuesve në baza ditore është rreth 80.

STATISTIKAT 2023		
Muaji	Orë të shfrytëzimit	Shfrytëzues
Janar	1409	132
Shkurt	1635	140
Mars	2221	148
Prill	2081	136
Maj	2489	147
Qershor	1728	143
Korrik	2471	140
Gusht	3540	149
Shtator	3664	146
Tetor	2610	148
Nëntor	1493	143

10.6 Statistika nga Drejtoria e Financave dhe Shërbimet e Përgjithëshme — produktet e AKK-së

Sistemi i faturimit është sistem i bazuar në ueb. Çdo javë nga sistemi i faturimit nxirret raport që përmban listën e produkteve të paguar me emër të produktit, sasinë e produkteve si dhe çmimin e produktit. Gjatë vitit 2023 janë shitur **20853** produkte të ndryshme dhe janë lëshuar **1326** fatura.



11

**BUXHET DHE
FINANCA**

11.1 Kesh plani- Plani i rrjedhës së parasë

Pas aprovimit të Ligjit nr.08-L-193 mbi Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023, AKK-ja ka përgatitur Planin e rrjedhës së parasë për vitin 2023 për dy fondet burimore të financimit (FB10) BKK dhe (FBO4-06) Huamarrja. Plani është hartuar duke u bazuar në planin e prokurimit dhe vlerësimet tjera të bazuar në shpenzimet nga viti paraprak.

11.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2023 (pasqyrat financiare)

Bazuar në standarde ndërkombëtare të kontabilitetit është përgatitur raporti vjetor financiar për vitin 2023. Ky raport pasqyron në mënyrë të saktë dhe të drejtë financat dhe transaksionet financiare të AKK-së brenda viti fiskal 2023.

11.3 Korniza Afatmesme e Shpenzimeve - KASH 2023-2025

Bazuar në instruksionet nga MFPT, AKK ka përgatitur kornizën afatmesme të shpenzimeve — KASH për vitin 2023 - 2025, duke marrë për bazë kërkesat e njëjësive kërkuese — Drejtorateve, të cilat janë dërguar në MMPHI.

11.4 Pyetësi Vetëvlerësues i komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Regjistri i rrezikut

Me qëllim të monitorimit të cilësisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit, MFPT obligon institucionet që ta plotësojnë pyetësin e vetëvlerësimit. Pyetësi përbëhet nga 106 pyetje.

Së bashku me pyetësin është përcjell edhe raporti vjetor i kontrollit të brendshëm dhe deklarata e kontrollit.

Bazuar në LMFPD dhe procedurat e MFK-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e AKK-së është përgatitur “Regjistri i rrezikut”. Në këtë formular janë trajtuar: objektivat, masat, prioritetet, projektet, përshkrimi i rrezikut, veprimet që duhet ndërmarrë, afatet e fundit kohore, sektorët përgjegjës dhe realizimi i planit.

11.5 Planifikimi i buxhetit për vitin 2024, 2025 dhe 2026, Qarkorja I dhe II

Bazuar në qarkoren e parë buxhetore të lëshuar nga MFPT, AKK ka finalizuar Planifikimin e buxhetit për vitet 2024, 2025 dhe 2026. Planifikimi është bërë bazuar në kërkesat e drejtorateve kërkuese brenda AKK-së.

11.6 Vlerësimi financiar

Deklarata financiare për Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKK, është përgatitur dhe dërguar në MMPHI së bashku edhe me memorandumin shpjegues për pjesën e ndikimit financiar.

11.7 Lista me shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve zyrtare

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr.08/L-111 për Arkivat, Rregulloren Nr. 01/2015 për shenjat unike të klasifikimit dhe afatet e ruajtjes së tyre dhe Rregullores (MPB) Nr.05/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (MAP)Nr.01/2015 për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre, Agjencia Kadastrale e Kosovës përmes komisionit të themeluar me vendim të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm, ka hartuar listën me Shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre.

11.8 Tjetërsimi i pasurisë

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, për pasuritë kapitale të blera me fonde prej granteve nga Qeveria e Kosovës ose që janë blerë me fonde donatorësh, Agjencia Kadastrale e Kosovës në harmoni me dispozitat ligjore procedurale që burojnë nga kjo rregullore, kemi kërkuar aprovimin në MFPT për tjetërsim, kërkesa është aprovuar.

11.9 Buxheti

Me Ligjin Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës Së Kosovë për vitin 2023, i cili ka hy në fuqi me datën 30.12.2022 me të cilin është përcaktuar buxheti i Republikës së Kosovës.

Agjencia Kadastrale e Kosovës financohet nga dy burime, nga Buxheti i Qeverisë dhe nga Huamarrja e Bankës Botërore. Vlera e buxhetit të ndarë për AKK-në në total ka qenë në vlerë: 4,647,537.31 €, i kategorizuar në katër kategori si: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale dhe Pasuri jo financiare.

Destinimi	Buxheti i planifikuar nga AKK(€)	Buxheti i aprovuar(€)	Buxheti i rishikuar(€)
Totali	981,774.36	887,537.31	947,537.31
Pagat	381,274.36	347,036.31	347,036.31
Mallra dhe Shërbime	260,000.00	200,001.00	260,001.00
Shërbime Komunale	5,500.00	5,500.00	5,500.00
Pasuri jo Financiare	335,000.00	335,000.00	335,000.00

Pasqyra e buxhetit, ndarja sipas kategorive, Fondi burimor 10

Në vitin 2023 AKK ka shpenzuar **1,534,431.91 €** në total nga dy fondet burimore të financimit-nga Buxheti i Qeverisë dhe Huamarrja.

- Buxheti i Qeverisë (fondi burimor 10) buxheti i realizuar është në vlerë prej: **908,808.14 €**
- Huamarrja (fondi burimor 04) buxheti i realizuar është në vlerë prej: **625,623.77 €**

Numri i lëndëve të realizuara - pagesa në total është : 764 lëndë.

Nga Buxheti i Qeverisë janë realizuar **190** lëndë dhe

Nga Huamarrja janë realizuar **574** lëndë

Destinimi	Buxhet/alokimi(€)	Shpenzimi (€)	Buxhet / Shpenzim(€)%
Totali	887,537.31 €	908,808.14 €	102%
Pagat	347,036.31	443,735.33	128%
Mallra dhe Shërbime	200,001.00	230,306.69	115%
Shërbime Komunale	5,500.00	2,279.67	41%
Pasuri jo Financiare	335,000.00	232,486.45	69%

Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive , Fondi burimor 10 Ndarja fillestare

Destinimi	Buxhet/alokimi(€)	Shpenzimi (€)	Buxhet / Shpenzim(€)%
Totali	947,537.31 €	908,808.14 €	96%
Pagat	347,036.31	443,735.33	128%
Mallra dhe Shërbime	260,001.00	230,306.69	89%
Shërbime Komunale	5,500.00	2,279.67	41%
Pasuri jo Financiare	335,000.00	232,486.45	69%

Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive, Fondi burimor 10 Ndarja finale

Destinimi	Buxhet/alokimi(€)	Shpenzimi (€)	Buxhet / Shpenzim(€)%
Totali	3,700,000.00 €	625,623.77 €	17%
Mallra dhe Shërbime	500,000.00	473,950.36	95%
Pasuri jo Financiare	3,200,000.00	151,673.41	5%

Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive, Fondi burimor 04-06, Huamarrja

Raporti është hartuar bazuar në të dhënat nga Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësi (SIMFK).

11.10 Të hyrat

Planifikimi i të hyrave për vitin 2023 ka qenë 123,500.00€.

Të hyrat e grumbulluara i përkasim dy kategorive si: Licenca për Kompani dhe gjeodet të licencuar (50201) dhe shitja e produkteve tjera (50401). Vlera e të hyrave për vitin 2023 është: 133,466.00 €.

Kodet	Janar-Mars	Prill-Qershor	Korrik-Shtator	Tetor-Nëntor	Totali
50401	24,501.00 €	31,117.00 €	24,608.00 €	39,020.00 €	119,246.00 €
50201	3,400.00 €	3,700.00 €	5,600.00 €	1,500.00 €	14,200.00 €
BK	27,901.00 €	34,817.00 €	30,208.00 €	40,520.00 €	133,446.00 €

Pasqyra e të hyrave sipas kostos

11.11 Prokurimi publik

AKK dorëzon raportin vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike për aktivitetet e prokurimit publik të AKK-së për vitin fiskal 2023 në Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP).

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në AKK, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë vitit 2023.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) Brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal 2023 ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) Planifikimin Final të Prokurimit, duke u bazuar në kërkesat e njëjësive kërkuese të aprovuara nga personat përgjegjës për buxhet dhe zv. Drejtorit të Përgjithshëm. Planifikimi i prokurimit ka qenë konform buxhetit të AKK-së për vitin fiskal në fjalë.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) bazuar në planifikimin e prokurimit për vitin fiskal 2023 ka zhvilluar 3 aktivitete të prokurimit. Secili proces i prokurimit në AKK është administruar përmes hapave në vijim: planifikimi i prokurimit, parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës, përcaktimi i procedurës së prokurimit, përgatitja e dosjes së tenderit, publikimi, hapja dhe vlerësimi i tenderëve, dhënia dhe nënshkrimi i kontratës, menaxhimi i kontratës. Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, AKK ka paraqitur të gjitha kontratat e nënshkruara. Tabela në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2023 në AKK.

Nr.	Titulli i projektit	Vlera e kontratës	Data e nënshkrimit
1.	Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive (projekt 2-vjeçar).	380,250.00€	09.06.2023
2.	"Mirëmbajtja e Sistemeve të Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës (SIKTK)".	122,100.00€	11.08.2023
3.	Avancimi i Infrastrukturës së TI-së (HW+SW).	9,850.00€	04.10.2023



12

**PJESËMARRJE NË
KONFERENCA, PUNËTORI,
GRUPE PUNUESE
DHE VIZITA STUDIMORE**

12.1 Vizitë në Arc në Maqedonisë Veriore

Ekspertët e AKK-së, pjesë e grupit punues për pregaditjen e termave të referencës për zhvillimet/avancimet në sistemet e AKK-së kanë vizituar Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive të Maqedonisë Veriore, ku janë takuar me drejtorin e AREC-ut z. Boris Tundzev dhe bashkëpunorët e tij. Diskutimi u fokusua për sistemet gjigjitate që ky insituvcion ofron për përpunimin e të dhënave kadastrale



12.2 Pjesëmarrje në takimin neqjional të organizuar nga BB

Një delegacion nga AKK ka marrë pjesë në takimin regjional të organizuar nga Banka Botërore në Vjenë, Austri me 27 dhe 28 prill. Në këtë takim nga AKK u prezentua për “Rolin dhe rëndësinë e përdorimit të të dhënave gjeohapësinore në menaxhimin e rreziqeve në rast të fatkeqësive natyrore në Republikën e Kosovës”.



12.3 Pjesëmarrje në punëtorinë e 4-të ndërkombëtare për kualitetin e të dhënave hapësinore

Përfaqësues nga AKK kanë marrë pjesë në Punëtorinë e 4-të Ndërkombëtare për Kualitetin e të Dhënave Hapësinore, organizuar nga EuroGeographics në Bruksel. Pjesëmarrësit e punëtorisë u fokusuan në prezantimin e praktikave më të mira të realizimit të kontrollit të kualitetit të të dhënave hapësinore, eliminimi i barrierave të ndërveprimit të të

dhënave, harmonizimi i të dhënave ndërshtetërore, siguria e ruajtjes së të dhënave, etj.

Pjesë të punëtorisë ishin përfaqësues nga institucione të ndryshme evropiane përfshirë: BKG Germany, Eurostat, IGN France, Kadaster Netherland, NGI Belgium, etj.



12.4 Punëtori AKK-USAID-ZKK Ferizaj

Në kuadër të Aktivitetit për Qeverisje Pronësore, USAID-i në bashkëpunim me AKK-në kanë mbajtur punëtori dy ditore me Komunën e Ferizajit lidhur me organizmin e mbrenshëm të ZKK-së, rrjedhjen e punës së lëndëve, rrespektimi i afateve kohore, kushtet e punës, stafi, etj.



12.5 Punëtori për projektin “Zhvillimi i moduleve të reja në sikt”

Është organizuar punëtori dy ditore mes ekspertëve të AKK-së dhe ZKK-ve për të diskutuar në detaje kërkesat, ndryshimet, problemet dhe mundësitë e avancimeve nëpër sistemet digjitate të AKK-së.



12.6 Punëtori në bashkëpunim me USAID dhe komunën e Suharekës, Rahovecit dhe Lipjanit

AKK, USAID dhe Zyrat Komunale Kadastrale ka mbajtur tri punëtori të ndara në kuadër të aktivitetit qeverisja e pronës lidhur me organizmin e mbrenshëm të ZKK-së, rrjedhjen e punës së lëndëve, rrespektimi i afateve kohore, kushtet e punës, stafi, etj.. Mbështetje në reforma me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve kadastrale premtuan edhe Kryetarët e komunave.



12.7 Punëtori për IKIH

Përfaqësues nga AKK, morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga AKP-ja për procesin e komasacionit. Diskutimi në këtë punëtori u fokusua fillimisht në pengesat ligjore të identifikuar nga AKP-ja lidhur me procesin e komasacionit ku janë përfshirë pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore. AKK-ja në anën tjetër dha sqarime kronologjike sa i përket regjistrimeve të këtyre pronave në Regjistra kadastral, sfidat me të cilat përballen pronarët e tyre dhe rekomandimin që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.



12.8 Pjesëmarrje në punëtorinë për komasacion e organizuar nga AKP

Zv. Drejtori i DL-së z. Bashkim Shaqiri dhe Zv. Drejtori i RDPP-së z. Hasim Pacolli morën pjesë gjatë në punëtorinë e organizuar nga AKP-ja për procesin e komasacionit. Diskutimi në këtë punëtori u fokusua fillimisht në pengesat ligjore të identifikuar nga AKP-ja lidhur me procesin e komasacionit ku janë përfshirë pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore. AKK-ja në anën tjetër dha sqarime kronologjike sa i përket regjistrimeve të këtyre pronave në Regjistra kadastral, sfidat me të cilat përballen pronarët e tyre dhe rekomandimin që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.



12.9 Pjesëmarrje në punëtorinë për shpronësim e organizuar nga MMPHI

Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së z. Avni Ahmeti me bashkëpunor morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga Departamenti i Shpronësimit për procesin e bartjes dhe regjistrimit në kadasër të pronave të shpronësuara. Diskutimi në këtë punëtori u fokusua fillimisht në elaborimin e procesit të shpronësimit, të arritura dhe sfidat të cilat e kanë përcjellur këtë proces ndër vite.



12.10 Punëtori dy ditore AKK, USAID, ZKK Gjilan në kuadër të aktivitetit qeverisja e pronës

Në kuadër të Aktivitetit për Qeverisje Pronësore, USAID-i në bashkëpunim me AKK-në kanë mbajtur punëtori dy ditore me Komunën e Gjilanit lidhur me organizmin e mbrendshëm të ZKK-së, rrjedhjen e punës së lëndëve, rrespektimi i afateve kohore, kushtet e punës, stafi, etj. Mbështetje në reforma me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve kadastrale premtuan edhe përfaqësues nga komuna.



Nga kjo punëtori ZKK-ja do të ketë të listuara hapat që duhet të ndërmarrë në drejtim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarë, llojin dhe natyrën e kërkesave që duhet drejtuar drejtorive tjera dhe zyrës së kryetarit për përkrahje, mënyrën e riorganizimit dhe ndryshimeve në staf, e pozita mbrenda ZKK-së dhe rekomandime të tjera që lidhen me përhshpejtimin e punës mbrenda ZKK-së



12.11 Pjesëmarrje ne aktivitetet per transformim digjital dhe eQeverisje

Me dy vendime të ndara të ZKM dhe MPB, drejtorja e DTIsë, znj. Afërdita Thaçi, emërohet anëtare e Komitetit Teknik për Transformim Digjital (vendimi nr.2956, datë 23.12.2022) dhe anëtare e Grupit Punues për hartimin e Strategjisë per eQeverisje (vendimi nr.2133, datë 30.12.2022)

Janë realizuar takime pune për Transformim Digjital dhe eQeverisje me ZKM, USAID, BB, ekspert/autoritete japoneze dhe franceze , GIZ, Akademia për eQeverisje e Estonisë (eGA), ASHI e departamentet e TIK të Institucioneve të Republikës së Kosovës, etj. Edhe këtë vit, sikurse edhe vitin e kaluar ka vazhduar pjesëmarrja aktive në grupin punues për hartimin e draft strategjisë për Qeverisje Elektronike.

Me vendimin e Qeverisë nr.11/165, datë 12.10.2023, aprovohet Strategjia e Kosovës për Qeverisje Elektronike 2023-2027 dhe Plani i Veprimit.



TRAINING

13

TRAJNIMET E
OFRUARA

13.1 Trajnimet e stafit të ZKK-ve

Gjatë vitit 2023 AKK-ja ka trajnuar më tepër se 30 zyrtarë të ZKK-ve në regjistrat kadastral SIKTK - T dhe SIKTK — HK.

13.2 Trajnimet e Gjeodetëve

Para licencimit gjeodetët mbajnë trajnim gjithëpërfshirës nga stafi i AKK-së të fokusuar në njohuri gjithëpërfshirëse nga legjislacioni që lidhet me fushën e kadastrit, pjesën e rrjedhës së punës së lëndëve në zyre kadastrale, njohuri për sistemet kadastrale, etj. Gjatë vitit 2023 në AKK janë trajnuar gjithsej **49 gjeodetë**.

13.3 Trajnimi i stafit të angazhuar për përditësimin e adresave

AKK-ja ka trajnuar 54 zyrtarë të angazhuar për përditësimin e adresave

13.4. Trajnimet e shfrytëzuesve të SIKTK-së nga institucionet tjera

13.4.1 Trajnimi i Noterëve

AKK ka mbajtur trajnim për të gjithë noterët e Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi nga afër me hapat që noterët duhet të ndjekin në Sistemin e shërbimeve digjitale të AKK-së, për regjistrimin e shënimit për njësitë kadastrale që do të jenë objekt i akteve noteriale.



Vendosja e këtij shënimi në regjistrin e të drejtave pronësore do të ngrisë nivelin e sigurisë së transakcioneve dhe do të ndihmojë në parandalimin e krijimit të dy ose më tepër akteve noteriale për njësitë e njejta kadastrale.

13.4.2 Trajnimi i Përmbauesve privat

AKK ka mbajtur trajnim për të gjithë Përmbauesit privat të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi nga afër me hapat që përmbauesit duhet të ndjekin në Sistemin e shërbimeve digjitale të AKK-së, për regjistrimin e shënimit për njësitë kadastrale që do të jenë objekt i Akteve përmbauesore.



Vendosja e këtij shënimi në Regjistrin e të drejtave pronësore do të ngrisë nivelin e sigurisë së të dhënave kadastrale dhe do të ndihmojë në parandalimin e zhvillimit të procedurave tjera për njësitë kadastrale me ndalesa nga Përmbauesit privat.

Trajnime në të cilat ka marr pjesë stafi i AKK-së:

- Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative;
- Trajnim “Microsoft Azure Administrator”.

Pjesëmarrja në grupe punuese:

- Hartimi i draft strategjisë për E-Qeverisja;
- Fuqizimi i Drejtësisë Civile dhe Administrative;
- Hartimi dhe finalizimin e Projektregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores MD-nr. 07/2023 për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përbërjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë;
- Hartimi i akteve nënligjore të përcaktuara në nenin 13 dhe 14 të ligjit Nr. 08-L-146 për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara;
- Hartimi i Planit të Integritetit;
- Vlerësimi i reciprocitetit me shtetet e tjera.

Pjesëmarrje në punëtori:

- Implementimi i Programit të Legalizimit të Ndërtimeve pa Leje;
- Menaxhimi i Ndryshimeve për Qeverinë dhe Aftësitë e të folurit në publik;
- Dizajnimi i Shërbimeve Qeveritare & Projektimi i proceseve të të menduarit (Design Thinking processes) dhe Aftësitë e të prezantuarit të ideve;
- Për shqyrtimin e procesit për realizimin e Ligjit Nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247;
- Për gjetjen e zgjidhjes për pajisjen e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian me statusin „Palë me Interes“ në pronën ku ata jetojnë me dekada të tëra por nuk janë pronarë ligjor, dhe t'ua mundësoj qasjen në dokumentacion lidhur me pronën (parcelën kadastrale) ku kanë ndërtuar shtëpitë e tyre, në procedurat administrative dhe gjyqësore;
- Rëndësia e Parandalimit të Konfliktit të Interesit, Roli i Autoriteteve Përgjegjëse sipas Legjislacionit, Praktikrat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare;
- Për finalizimin e akteve nënligjore të AKKVP: Draft-Rregullorja për Procedurat e Trajtimit të Informalitetit nga AKKVP dhe Draft- Rregullorja për Procedurat, Kushtet dhe Kriteret rreth Administrimit të Pronave dhe Zbatimin e Skemës Vullnetare të Qirasë;
- Për thjeshtimin e procesit të legalizimit;
- Për të analizuar dhe dizajnuar kërkesat për avancim të sistemeve digjitale;
- Sinjalizimi, hetimi administrativ, roli i zyrtarëve përgjegjës dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;

14

LICENCIMI I GJEODETËVE
DHE
KOMPANIVE GJEODETE

14. LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE

Një nga obligimet dhe përgjegjësitë ligjore të Agjencisë Kadastrale e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/-L-013 për Kadastër, është edhe licencimi i Gjeodetëve dhe Kompanive gjeodete.

Me Udhëzimin Administrativ MMPH-13/2019 për Licencimin e Kompanive gjeodete dhe Gjeodetëve, përcaktohen kushtet dhe procedurat e licencimit të Kompanisë gjeodete, Gjeodetit të licencuar, personave fizik të veçantë të licencuar, si dhe Teknikut gjeodet të licencuar. Gjatë vitit 2021, ka hyrë në fuqi edhe Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive gjeodete dhe Gjeodeteve, ku janë përcaktuar kushtet dhe kriteret e licencimit, siç janë: kalueshmëria e testit, moshja e pensionimit, etj.

Gjatë vitit 2023, në Republikën e Kosovës janë licencuar gjithsej 32 Gjeodet, 1 Teknik gjeodet, dhe 6 Kompani gjeodete.

Periudha e aplikimit 2023	Numri i aplikuesve	Numri i zyrave të kontrolluara	Numri licencave për Kompani gjeodete	Numri i licencave për Teknik gjeodet	Numri i aplikuesve të refuzuar	Numri i licencave për Gjeodet
Janar	12	7	1	-	4	7
Mars	14	11	2	-	4	8
Qershor	19	17	4	1	2	12
Shtator	4	4	-	-	1	4
Gjithsej	49	39	7	1	11	31

15

MONITORIMI I ZYRAVE
KADASTRALE
KOMUNALE, KOMPANIVE TË
LICENCUARA GJEODETE DHE
GJEODETËVE TË LICENUAR

15.1 Monitorimi i ZKK-ve

Bazuar në dispozitën e nenit 4, paragrafit 10 të Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër, AKK është përgjegjëse për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve kadastrale, aktivitetet këto të cilat ligjërisht janë të deleguara në ZKK, Kompani gjeodete dhe Gjeodet të licencuar. Me qëllim të realizimit të kësaj përgjegjësie AKK ka formuar grupet punuese për monitorimin e punëve dhe aktiviteteve kadastrale, i cili është përgjegjës për realizimin e kontrollit të lëndëve e të cilat janë të regjistruara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK).

Që nga viti 2014, AKK ka realizuar monitorime të rregullta, ku për secilën prej tyre janë hartuar raportet dhe të njëjtat janë dërguar tek kryetari i komunës dhe drejtori i zyrës kadastrale komunale. Të gjitha raportet e monitorimeve të bëra deri më tani janë të hapura për publikun në ueb faqen e AKK-së, <https://akk.rks-gov.net/sq/dokumente>. Monitorimi i këtij viti ka qenë i teti me radhë, duke përfshirë pjesën grafike, atë pronësore-juridike dhe pjesën tekstuale.

AKK-ja ka monitoruar lëndët nga muaji Korrik 2022 deri në Mars 2023. Lëndët janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga sistemi dhe ato janë kontrolluar në aspektin teknik dhe ligjor kanë të bëjnë me ndarje dhe bashkim të parcelave, regjistrim të ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesës, shitblerje, trashëgimi, hipotekë, etj., si edhe procesi i azhurnimit të tyre në SIKTK. Gjatë periudhës maj 2023 deri në dhjetor të vitit 2023, janë monitoruar 13 Zyra Kadastrale Komunale.

Pas kontrollimit të lëndëve për secilën ZKK është përpiluar raporti i monitorimit, i cili është përcjellë, te disa prej kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të ZKK-ve me kërkesë për eliminimin e parregullsive të evidentuara.

Numri dhe llojet e lëndëve të kontrolluara për çdo komunë është paraqitur në tabelën më poshtë:

Statistikat nga lëndët e pjesës ligjore të monitoruara gjatë vitit 2023	
Komuna	Numri i lëndëve të monitoruara
Shtime	23
Kllokot	11
Klinë	18
Deçan	11
Novobërdë	14
Dragash	10
Graçanicë	22
Podujevë	11
Mamushë	10
Vushtrri	13
Suharekë	19
Skenderaj	16
Rahovec	16
Gjithsej	194

15.2 Monitorimi i Kompanive të licencuara gjeodete dhe Gjeodetëve të licencuar

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023, Komisioni për Monitorimin e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuar ka zbatuar procedurat e Licencimit, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2019.

Pasi që ka njoftuar fillimisht të gjithë gjeodetët e licencuar dhe kompanitë gjeodete të licencuara për obligimet që rrjedhin nga udhëzimi administrativ, janë bërë monitorime në zyrat e gjeodeteve të licencuar nëpër komunat e Podujevës, Klinës, Mitrovicës Jugut, Vushtrrisë, Rahovecit, Suharekës, Klinës dhe Istogut. Gjatë këtyre monitorimeve janë inspektuar **17 gjeodetë të licencuar dhe 1 kompani gjeodete e licencuar**.



16

MARRËDHËNIE
ME PUBLIK
DHE
GJITHËPËRFSHIRJE

16.1 Ueb faqja zyrtare e AKK-së

Ueb faqja e re është kanali zyrtar i komunikimit mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe palëve të ndryshëm të interesit. Gjithashtu është një pikë kontaktuese për qasje në ueb aplikacionet tjera të AKK-së: KCLIS tekstual, KCLIS grafik, Geoportal, Sistemi Informativ i Regjistrimit të Adresave (ARIS), statistikave ditore dhe modulet tjera që do të zhvillohen në të ardhmen.

Në vitin 2023 në Ueb faqen e e AKK-së janë publikuar 64 lajme, 29 shpallje, disa udhëzime administrative, gazeta zyrtare e AKK-së, etj. Përveç publikimeve janë realizuar edhe aktivitete tjera administrative si konfigurime të ndryshme në CMS.

Në viti 2023 Ueb faqja e AKK-se ka pasur **21K** vizita.

16.2 Facebook

Mediat sociale sot kanë zënë një vend shumë të rëndësishëm në informimin e shpejtë dhe gjithëpërfshirës të qytetarëve. Informacionet e shpejta, të sakta dhe kredibile në vitet e fundit nga fusha e kadastrit, specifikisht punën dhe aktivitetin e AKK-së e ka pasqyruar profili i Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Facebook. Ky profil sot numëron **6 mijë ndjekës**.

Agjencia Kadastrale e Kosovës falënderon secilin për mbështetjen dhe besimin që kemi në institucionin tonë, duke u zotuar për punë dhe angazhim maksimal edhe në të ardhmen.

Gjatë vitit **2023** janë publikuar **85 lajme**, janë bërë **5540 like** dhe janë bërë **211 share**.



16.3 Gazeta periodike “KADASTRA”

Agjencia Kadastrale e Kosovës prej vitit 2019 ka filluar edhe shtypin dhe publikimin e gazetës periodike të saj “Kadastra”, që ka për qëllim informimin e palëve të ndryshme të interesit mbi aktivitetet, produktet, shërbimet dhe projektet e saja.

Gjatë vitit 2023 për shkak të shumë aktiviteteve është publikuar vetëm një edicion i gazetës në të cilën janë përfshirë disa nga aktivitetet më të rëndësishme në gjashtë mujorin e fundit të vitit.

Ky numër i edicionit të fundit të “Kadastra”-s është shpërndarë në disa prej institucioneve publike në Republikën e Kosovës.




16.4 Gjeoportali Shtetëror

Gjatë vitit 2023 është vazhduar me ritmin e njëjtë të mirëmbajtjes së Gjeoportali-it si edhe në vitet e kaluara. Mund të themi se në 99.8% të kohës Gjeoportali ka qenë i qasshëm dhe funksional.

Fokusi më i madh gjatë këtij viti ka qenë përditësimi i të dhënave aktuale të cilat veçse janë të publikuara në Gjeoportali, mirëpo në të njëjtën kohë është vazhduar edhe me publikimin e të dhënave të reja nga Institucione të ndryshme në Gjeoportali.

Në vitet e fundit është vërejt një rritje në shfrytëzimin e Gjeoportalit si nga qytetarët ashtu edhe nga bizneset. Më poshtë është treguar numri i përdoruesve dhe i klikimeve për 3 vitet e fundit.




16.5 Barazia gjinore

Me vendim të Qeverisë Nr. 08/68 i datës 23.03.2022 është vazhduar afati i Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të Dy Bashkëshortëve.

Statistikat për regjistrimin e bashkëshortëve si bashkëpronar nëpër vite nga hyrja e Udhëzimit Administrativ e deri më tani janë paraqitur në tabelën më poshtë:

VITI	Nr.i femrave të regjistruara me të drejtën Pronësi e përbashkët
2019	1464
2020	1583
2021	3042
2022	4230
2023	5104



16.6 Qasja në dokumente publike

Agjencia Kadastrale e Kosovës është ndër institucionet më transparente në vend. Ajo ka të vendosur kontaktin e personit që jep përgjigje në uebfaqen e Agjencisë. Këtë vit ka pasur nga dhjetëra kërkesa për qasje në dokumente, që kryesisht vijnë nga mediat, OJQ-të dhe qytetarët.

SUNDAY	MONDAY	TUESDAY	WEDNESDAY	THURSDAY	FRIDAY	SATURDAY
		1	2 Stat meeting	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13 -MR. John 10 AM - Team meeting	14	15	16 SEMINAR @ New York	17	18	19
20	21	22	23	24 break	25	26
27	28	29	30 Conference skype	31		

17

**KALENDARI
ME NGJARJE
TË RËNDËSISHME**

17.1 (12 Janar) Takimi me Zyrtarët e Urbanizmit për Projektin e Adresave


Lidhur me përditësimin dhe kompletimin e të dhënave të adresave janë nënshkruar kontratat me 26 zyrtar të rinjë si mbështetje për komuna, të cilët edhe janë trajnuar nga stafi i AKK-së. AKK gjithashtu ka mbajtur trajnim për këta zyrtarë cilët do të punojnë si Staf Mbështetës komunal në drejtoritë



e urbanizmit. Trajnimi u fokusua në dhënien e udhëzimeve për përditësimin e të dhënave të adresave dhe synon të rrisë cilësinë e shërbimeve që ofrohen në këtë fushë.

17.2 (10 Shkurt) Digjitalizimi i regjistrimit të barrës tatimore

Në bashkpunim me Administratën Tatimore të Kosovës, AKK ka arritur një zhvillim mbi regjistrimin e ngarkesave (barrës tatimore) në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme




17.3 (20 Mars) Koordinimi i aktiviteteve të planit kombëtar zhvillimor

AKK në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor ka planifikuar realizimin e 13 aktiviteteve të aspektit ligjor dhe investimeve kapitale, për të cilat është mbajtur takim pune mes Zv. Drejtori i Përgjithshëm të AKK-së z. Avni Ahmeti dhe ministrit të MMPHI Z. Liburn Aliu me qëllim të informimit mbi ecurin e aktiviteteve, benefitet nga implementimi i tyre dhe sfidat me të cilat ballafaqohet AKK. Me këtë rast Ministri ofroi mbështetje për realizimin e këtyre projekteve.



17.4 (30 Mars) AKK përshpejton regjistrimin e pronave në emër të Republikës së Kosovës

Me kërkesën e Ministrisë së Mbrojtjes, MMPHI përmes AKK-së ka marrë përsipër azhurnimin e parcelave të shpronësuara në RDPP, e gjithë kjo për tu hapur rrugë investimeve strategjike në FSK. Në këtë regjistrim janë përfshirë 407 parcela në Komunën e Gjakovës për ndërtimit të “Poligonit Kryesor të Trajnimeve” për nevoja të FSK-së dhe 24 parcela për lokacionin e ish “Aeroportit të Gjakovës”.



17.5 (5 Prill) Takim koordinues në mes të AKK-së dhe USAID-it

Takimi mes zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AKK-së Z. Avni Ahmeti dhe Drejtoreshës së Aktivitetit për Qeverisjen e Pronës znj. Jannifer Ober me bashkëpunëtor u realizua për të kërkuar përkrahje për realizimin e një projekti në Komunën e Shtërpcës, organizimin e punëtorive të ndryshme, informimin publik dhe përkrahjen për hapjen e të dhënave.




17.6 (7 Prill) Takim me N.H. “IBER LEPENC”

Në takimin mes zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AKK-së Z. Avni Ahmeti dhe Kryeshefit të N.H. “Iber Lepenc” z. Faruk Mujka është diskutuar për qasjen në SIKTK, sqarimin e procedurave për azhurnimin e të dhënave grafike për pronat e N.H. “Iber Lepenc”, regjistrimin e vendimeve të servitutit, harmonizimin dhe korrektimin e emërtimeve të ndërmarrjes në sistemin kadastral, digjitalizimin e arkivës e të ngjashme.



17.8 (27 Prill) Takim me USAID-in për Qeverisje Ekonomike

Në takimin mes AKK dhe përfaqësuesve të USAID-it për Qeverisje Ekonomike, u dakorduan për organizimin e një punëtorie me qëllim të trajtimit të problemeve dhe thjeshtësimin e procedurave lidhur me lëndëve të Legalizimit të Kategorisë së dytë dhe hartimin e konkluzave, rekomandimeve për zyrtarët komunal.



17.7 (20 Prill) Takim me Odën e Përmbauesve Privat të Kosovës

Është realizuar takimi mes AKK-së dhe përfaqësuesve të Odës së Përmbauesve Privat të Kosovës, ku u diskutua për krijimin e mundësisë për regjistrimin e shënimit në RDPP, ku në një afat të shkurtë kohor AKK-ja do të pregadisë mundësitë teknike për qasje duke marrë nga ta sugjerimet dhe kërkesat për përshtatje të nevojave dhe përdorim nga ana e tyre.



17.9 (5 Maj) Takim me AKKVP dhe OSCE

Zv. Drejtori i Përgjithshëm i AKK-ës z. Avni Ahmeti ka pritur në takim zv. Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të AKKVP z. Arben Pasjaqa, si dhe z. Bilbil Krasniqi përfaqësues nga OSBE. AKK dhe AKKVP, do të vazhdojnë bashkëpunimin institucional të deritanishëm, me fokus angazhimin në zbatimin e rekomandimeve të dala nga Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë. OSBE do të mbështesë realizimin objektivave dhe aktiviteteve të të dy agjencive.



17.10 (15 Maj) Takim Koordinues Mes AKK-së, APK-së, AKP-së dhe Ministrisë së Bujqësisë

Duke pasur parasysh që pronat e Agjencisë Pyjore të Kosovës në Regjistrin e të Drejtave Pronësore janë të regjistruara në forma dhe emërtime të ndryshme, ka qenë i nevojshëm një takim mes palëve me qëllim të diskutimit për mënyrën e unifikimit të këtyre emërtimeve gjithashtu për mënyrën e bartjes së pronësisë së këtyre pronave në pronësi të definuar nga ligji.

Pjesëmarrës në takim ishin: nga Ministria e Bujqësisë — Departamenti i pylltarisë Z. Naser Krasniqi, nga Agjencia e Pyjore e Kosovës UD. Kryeshefi Z. Fidan Dema, dhe Drejtori i Drejtoratit ligjor si dhe nga Agjencia e Privatizimit, Petrit Ibraj Drejtor-Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Drejtori i Zyrës Regjionale të Prishtinës dhe nga AKK Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Z. Avni Ahmeti, Zv. Drejtorët e Drejtorateve Ligjor dhe të Kadastrit dhe ekspertë tjerë



Me hyrjen në fuqi të Ligjit NR.08/L-137 për Pyjet, sipas nenit 8 të këtij ligji, paragrafi 1: Pyjet, tokat pyjore dhe kullotat në pronësi shtetërore, publike apo shoqërore, Ekonomitë Pyjore, Ekonomitë e Gjuetisë dhe Ndërmarrjet Shoqërore të regjistruara sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Shoqërore - (Gazeta Zyrtare Nr. 77/88), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 40/89, 46/90 dhe 61/90 apo Organizatat Themelore të Punës së Bashkuar (OTHPB): “Ekonomia Pyjore” - Shumsko Gazdinstvo” apo çfarëdo emërtimi tjetër që ishte regjistruar si pronar ose shfrytëzues i pronës shoqërore, shtetërore apo publike dhe është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, janë pronë e Republikës së Kosovës me të cilën menaxhon Agjencia. Gjithashtu në paragrafin 2 thuhet që: Pyjet dhe tokat pyjore shtetërore regjistrohen me pronarë Qeveria e Republikës së Kosovës.

17.11 (26 Maj) Takimi i komitetit të praktikave të mira

Në kuadër të Aktivitetit për Qeverisje Pronësore, AKK-ës në bashkëpunim me USAID-in kanë organizuar takimin e radhës së Komitetit të praktikave të mira me pjesëmarrës nga komunat e Pejës, Suharekës, Ferizajit, Rahovecit dhe Lipjanit. Pjesëmarrës ishin edhe inspektorë nga MMPHI, e gjithashtu edhe zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë. U prezantua rezultati i anketës njohurive, qëndrimit dhe perceptimit të qytetarëve në lidhje me shërbimet kadastrale, u prezentuan poashtu edhe reformat ligjore në administrimin e tokës dhe kadastër, eliminimi i barrierave të ndryshme të cilat kanë ndikim në realizimin e të drejtave, Ligji për IKIH, etj.



17.12 (31 Maj) Takim me përfaqësuesit e zyrës japoneze për bashkëpunim - JICA

Në takim u diskutua në detaje mbi përdorimin e informacionit gjeohapësinor për menaxhim dhe planifikim, në linjë me praktikën më të mira shtetërore dhe ndërkombëtare. Me fokus të veçantë në ngritjen e kapaciteteve për Agjencinë Kadastrale në krijimin e hartave topografike me shkallë të ndryshme, dhe përdorimin e informatave gjeohapësinore në dobi të kërkesave dhe nevojave të planifikimit të qëndrueshëm.



17.13 (2 Qershor) Përfaqësues të misionit të bankës botërore për projektin REGIP kanë vizituar AKK-në

Zv. Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së z. Avni Ahmeti dhe Udhëheqësi i Ekipit të Bankës Botërore z. Paul Prettitore, shprehën gatishmërinë për intensifikim të bashkëpunimit dhe implementimit të aktiviteteve sipas planifikimit të paraparë. REGIP përbën një ndër projektet më kapitale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i përbërë nga katër komponentë kryesore, që ka për qëllim mbështetjen ligjore e institucionale, modernizim e kadastrit, përmirësimin e infrastrukturës kombëtare për informacionin gjeohapësinor, menaxhim dhe ngritje të kapaciteteve.



17.15 (14 Qershor) Takim me Shoqatën e Gjeodetëve

Në takim u prezentuan nismat e AKK-së për reforma ligjore përfshirë Projektligjin e Kadastrit, projektet e planifikuara për tu realizuar dhe fillimi i monitorimit të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara. Në veçanti u prezentua Moduli i gjeodetëve i cili do të iu ofrojë qasje më të lehtë dhe më të shpejtë gjeodetëve në regjistra kadastral, përfshirë edhe azhurnimin e të dhënave në pjesën grafike dhe tekstuale nga vet ata dhe rritje të fundit në procesin e digjitalizimit të shërbimeve kadastrale dhe ofrimin e informacioneve në kohë reale për qytetarë.



17.14 (9 Qershor) Takim me Administratën Tatimore të Kosovës

Temat e diskutimit ishin zhvillimet e fundit të AKK-së me qëllim digjitalizimit të regjistrimit të barrës tatimore, trajtimin e vlerës së borxhit tatimor, shfrytëzimin e adresave të bizneseve tatimpaguese, etj. AKK-ja u zotua që do të bëjë anagazhim maksimal në plotësimin e kërkesave të ATK-së, por të njëjtën kohë edhe nga ATK-ja u kërkua që të përmbushen obligimet e ture konform kërkesave të AKK-së.



17.16 (12 Korrik) Mbahet Testi për Licencim të Gjeodetëve në Republikën E Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka mbajtur testimin elektronik për licencimin e gjeodetëve të rinjë, dhe ri licencimin e gjeodetëve të cilët kanë ushtruar veprimtarinë e tyre më parë në ofrimin e shërbimeve kadastrale. Testi për Licencim përmban materien që rregullon fushën e kadastrit dhe regjistrimit të të drejtave sendore në Republikën e Kosovës.



17.17 (14 Korrik) Për herë të parë akk ka filluar monitorimin e drejtëpërdrejtë të punëve të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuar në vend

Një grup ekspertësh nga AKK, të caktuar nga zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së, për herë të parë ka filluar monitorimin e drejtëpërdrejtë të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara, fillimisht në Komunat: Rahovec, Suharekë dhe Mitrovicë e Jugut.



Monitorimi në terren do të vazhdojë edhe përgjatë ditëve në vijim, me komuna dhe gjeodetë të tjerë për të parë nga afër punën dhe sfidat e të gjitha zyrave të gjeodetëve/dhe kompanive gjeodete të licencuara, me qëllim ngritjen e kualitetit të shërbimeve kadastrale për qytetarët.

17.19 (9 Gusht) AKK shpërndan licencat për gjeodetë dhe kompani gjeodete

AKK si organ kompetent për licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet të cilat rrjedhin nga Udhëzimi Administrativ për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve. Pasi që i janë nënshtruar procesit të licencimit, respektivisht pas plotësimit të kushteve për licencim, në ambientet e AKK-së janë shpërndarë licencat për gjeodetë.



17.18 (26 Korrik) Takim me Ekspertët e Bankës Botërore

Në takimin mes ekspertëve të BB-së dhe AKK-së u diskutuan dhe sqaruan detajet për hartimin e specifikave teknike, për projektet e planifikuara për këtë periudhë kohore, në kuadër të projektit REGIP.



17.20 (15 Gusht) Takim me KFOR-in Britanik

Është mbajtur takim në mes të z. Avni Ahmeti, zv. Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë dhe përfaqësuesve të KFOR-it Britanik. Qëllimi i takimit ishte informimi i ndërsjellët për punët dhe aktivitetet e AKK-së, mundësia e bashkpunimit dhe e shkëmbimit të disa të dhënave statistikore.



17.21 (13 Shtator) AKK monitoron në terren aktivitetet në kuadër të projektit rilevimi Aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës

Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së, z. Avni Ahmeti së bashku me ekspertët e AKK-së, kanë bërë monitorimin në terren për punët gjeodezike të projektit, ku janë kontrolluar disa pika kontrolluese tokësore. Bazuar në planin dinamik, në këtë periudhë kohore është planifikuar të fillojë sinjalizimi i pikave kontrolluese në



terren për blloqet urbane dhe rurale të cilat bazuar nga monitorimet e AKK-së plotësojnë standartet dhe saktësinë e kërkuar. Ky projekt ka filluar me 06.07.2023 dhe do të plotësojë nevojat e qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme të Republikës së Kosovës për fusha të ndryshme që ato mbulojnë, si: Agjencisë Kadastrale të Kosovës, për çështje kadastrale, hartografike, sistemit të adresave, etj, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, për planifikim urbanistik, infrastrukturën rrugore, menaxhimin e ujerave etj, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për menaxhimin e pyjeve, tokave bujqësore etj, Ministrisë së Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë, etj, Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave për fatkeqësitë natyrore, etj, Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare, etj, Ministrisë së Mbrojtjes FSK-së për veprimtaritë ushtarake, etj.

17.22 (20 Shtator) Takimi i radhës i komitetit të praktikave të mira

Në kuadër të Aktivitetit për Qeverisje Pronësore, AKK në bashkëpunim me USAID-in kanë organizuar takimin e radhës së Komitetit të praktikave të mira me pjesëmarrës zyrtarë nga komunat e: Pejës, Ferizajit, Lipjanit, Suharekës, Rahovecit, Obiliqit, Mitrovicës së Jugut, Gjakovës, Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës. Pjesëmarrës ishin gjithashtu edhe zyrtarë nga Zyra e Kryeministrit, MMPHI, MD dhe MF - Departamenti i Tatimit në Pronë.

Temë diskutimi ishin “Ndryshimet ligjore në legjislacion në lidhje me ankesat kundër vendimeve të ZKK-së dhe AKK-së” dhe Programi Qeveritar për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 (me fokus në shërbimet kadastrale).



17.23 (29 Shtator) Takim me përfaqësuesit E GIZ-it Gjerman

Për të gjetur metodologjinë me të përshtatshme për të realizuar projektin ndërlidhje të qytetarëve me adresë zyrtare, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe AKK, nën monitorimin dhe mbështetjen e Zyrës së Kryeministrit, kanë vendosur të realizojnë një pilot projekt, ku u realizua për Komunën e Istogut dhe Mitrovicës së Jugut. Këtë projekt e ka mbështetur GIZ-I Gjerman.

Në kuadër pilot projektit kanë qenë të parapara dy aktivitete, si: zhvillimi I aplikacionit SELQA I cili mundëson mbledhjen (përmes tabletave) dhe mirëmbajtjen e të dhënave të qytetarëve me adresë zyrtare. Aplikacioni SELQA mundëson mbledhjen e të dhënave, numrave personal të qytetarëve dhe adresave zyrtare si dhe mirëmbajtja dhe shpërndarja e të dhënave të ndërlidhura.



17.24 (18 Tetor) Vizita e Misionit të Bankës Botërore në AKK

Në kuadër të vizitës zyrtare të misionit të Bankës Botërore e filluar nga data 16.10.2023 deri në datën 20.10.2023 sa zgjati vizita, stafi i AKK-së i udhëhequr nga Zv. Drejtori i Përgjithshëm Avni Ahmeti zhvilloi takime të rëndësishme me përfaqësues të Bankës Botërore, të cilët janë të angazhuar direkt me projektin REGIP



REGIP përbën një ndër projektet më kapitale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i përbërë nga katër komponentë kryesore, që ka për qëllim mbështetjen ligjore e institucionale, modernizim e kadastrit, përmirësimin e infrastrukturës kombëtare për informacionin gjeohapësinor, menaxhim dhe ngritje të kapaciteteve.

17.25 (25 Tetor) Takimi i dytë koordinues mes AKK-së, AKP-së dhe Ministrisë së Bujqësisë

Duke pasur parasysh që pronat e Agjencisë Pyjore të Kosovës në RDPP janë të regjistruara në forma dhe emërtime të ndryshme, ka qenë i nevojshëm takim mes palëve me qëllim të diskutimit për mënyrën e unifikimit të këtyre emërtimeve gjithashtu për mënyrën e bartjes së pronësisë së këtyre pronave në pronësi të definuar nga ligji.



Në takimin e radhës pritet që të nënshkruhet edhe një Memorandum bashkëpunimi mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës. Palët u dakorduan që do të mbeten në kontakt të vazhdueshëm për këtë çështje dhe do të organizojnë edhe takime tjera sipas nevojës.

17.26 (28 Shtator) Projekti për matjen e rrugëve të reja në teren

Në kuadër të projektit REGIP të BB, AKK ka paraparë edhe komponentin për kompletimin e Sistemit të Adresave në Republikën e Kosovës, ku janë paraparë disa aktivitetet si: matja e rrugëve të reja në teren, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave të adresave, prodhimi dhe instalimi i tabelave të emrave



të rrugëve dhe numrave të adresave për komunat e ku mungojnë, ndërlidhja e qytetarëve me Adresa zyrtare dhe zhvillimi i aplikacionit ARIS mobile. Aktiviteti për matjen e rrugëve të reja në teren ka përfunduar me sukses. Ky aktivitet ka filluar në maj të vitit 2023 dhe ka përfunduar në gusht të vitit 2023. Ky aktivitet ka pasur për qëllim matjen e rrugëve të reja të cilat kanë qenë të skicuara paraprakisht nga ana e komunave dhe më pastaj përmes GPS është bërë matja e rrugëve. Gjatësia e rrugëve të skicuara nga komunat ka qenë rreth 635628 metra, kurse rrugë të matura në fund të projektit ishin rreth 797165 metra.

17.27 (19 Tetor) Komisioni për mjedis, ushqim, bujqësi, planifikim dhe zhvillim aprovon projektligjin për kadastër të pronës së paluajtshme

Pas miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe votimit të leximit të parë nga Kuvendi i Kosovës, Projektligji për Kasdastër të Pronës së Paluajtshme është shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim



17.28 (25 Tetor) AKK vizitë në ZKK Shtërpcë

Pas ankesave dhe kërkesave të shumta që qytetarët kanë pasur gjatë këtij muaji për vështirësi në marrjen e shërbimeve nga ZKK Shtërpcë Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti me bashkëpunëtorë ka vizituar këtë komunë për tu informuar nga afër me problemet dhe sfidat që po përballen ata.



Numri i madh i lëndëve të paregjistruara, kushte jo të mira për punë dhe staf shumë i vogël janë disa prej sfidave që po përballen kjo ZKK. Ankesat e ZKK-së kanë të bëjnë kryesisht me gjendjen e të dhënave që rezultojnë të mos jetë azhurnimi i fundit në SIKTK, në pothuajse 60% të rasteve specifikisht në dy zona kadastrale. AKK kërkoi nga ZKK që të dorëzojnë një raport të detajuar për numrin e lëndëve të pa azhurnuara, përfshirë llojin e tyre dhe specifikat e veçanta për secilën prej tyre. Më pas ky raport do të analizohet nga AKK-ja dhe do të shikohen të gjitha mundësitë ligjore e financiare për të mbështetur ZKK-në në zgjidhjen e këtij problemi.

17.29 (30 Tetor) Takim me agjencinë për parandalimin e korrupsionit

Në takimin e mbajtur në AKK u diskutua në lidhje me mundësinë e verifikimit të pronarëve që tashmë janë verifikuar më herët me kërkesa fizike në AKK. Për të thjeshtuar dhe shpejtuar verifikimin palët u dakorduan për zhvillime të reja në sistemet digjitale për të mundësuar komunikim nëpërmjet ueb shërbimeve.



17.30 (2 Nëntor) AKK fillon dorëzimin e raporteve të monitorimit tek kryetarët e komunave dhe drejtorët e ZKK-ve

AKK-ja ka filluar vizitat nëpër komuna në të cilat ka përfunduar tashmë monitorimi punëve dhe aktiviteteve nga grupi monitorues i AKK-së. Ky monitorim është i teti me radhë, ndërsa i pari pas hyrjes në fuqi të Udhëzimeve Administrative të reja.



Për të dorëzuar këto raporte me gjetjet dhe rekomandimet nga ky proces, Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti, bashkë me Zv. Drejtorin Ligjor Bashkim Shaqiri dhe Drejtoreshën e Financave Fazile Hamiti u takuan me Kryetarin e Komunës së Skënderajit Z. Fadil Nura

17.31 (8 Nëntor) Takim me përfaqësuesit e projektit PIAKOS

AKK mbajti takim me përfaqësuesit e projektit për shërbimet e informimit publik dhe vetëdijesimit për komunitetet pakicë në Kosovë (PIAKOS), i zbatuar nga Qendra për Trajnime dhe Burime për Avokim (ATRC). Objektivi i këtij projekti të financuar nga Banka Botërore është përmirësimi i qasjes në



informatat për regjistrimin e tokës dhe pronës dhe shërbimet këshilluese për gratë, të rinjtë dhe komunitetet pakicë në Republikën e Kosovës. U diskutua edhe për mundësinë e bashkërendimit të aktiviteteve tjera që PIAKOS mund ta ndihmojë AKK-n për implementimin e projekteve si: Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale, Finalizimi i Sistemit të Adresave, Korrigjimi i të dhënave në SIKTK, implementimi i infrastrukturës kombëtare të informacioneve hapësinore etj.

Pjesëmarrës në hapje zyrtare të ZKK-ve ishte edhe Zv.Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti i cili premtoi që Agjencia Kadastrale e Kosovës do të vazhdojë mbështetjen e plotë për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve sa më të mira kadastrale dhe sa më afër qytetarëve.



17.32 (10 Nëntor) Dorëzimin e raporteve të monitorimit tek zyrtarët e komunës së Shtimes

Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti, bashkë me Zv. Drejtorin Ligjor Bashkim Shaqiri dhe Drejtorin e RDPP-së z. Hasim Pacolli u takuan me Nënkryetarin e Komunës së Shtimes z. Faruk Beqa, Shefen e kabinetit të kryetarit znj. Anita Kurti si dhe Drejtorin e ZKK-së z. Grejtalb Emini, për të dorëzuar raportin e monitorimit dhe diskutuar gjetjet e këtij raporti.

Për të shpërndarë Certifikatat e para të pronësisë prezent në këto komuna ishte edhe Ministri Liburn Aliu. Ministri në fjalën e tij për media uroi qytetarët e këtyre komunave për shërbimet e reja që iu janë shtuar atyre, duke iu premtuar edhe përkrahje të mëtutjeshme.

17.33 (14 Nëntor) Takim me kryetarët e Komunave Veriore

Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti priti gjatë ditës në një takim të përbashkët kryetarët e Komunave Veriore Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore dhe përfaqësues të kabinetit të kryetarit të Leposaviqit. Në këtë takim temë qendrore ishte informimi në lidhje me përgatitjet e fundit të AKK-së për funksional-



izimin e Zyreve Kadastrale Komunale në të gjitha komunat veriore. Deri më tani shërbimet kadastrale për këto komuna janë kryer në zyret AKK-së në Prishtinë, por nga muaji i ardhshëm planifikohet që ky shërbim të ofrohet në këto lokalitete dhe afër qytetarëve të cilët kanë nevojë për këto shërbime.

17.34 (5 Dhjetor) AKK pret në takim ekspertë të bankës botërore në kuadër të projektit “Rritja e Cilësisë dhe Fushëveprimit të Regjistrimit të Tatimpaguesve”

Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti së bashku me Zv. Drejtori i DL-së z. Bashkim Shaqiri dhe Ekspertin kadastrale Esat Xani, priti në takim ekspertët e Bankës Botërore: Mediha Agar, Jonas Arp Fallov, Katarina Dulic dhe William Mccluskey, të cilët i informuan nga afër të pranishmit për projektin “Rritja e Cilësisë dhe Fushëveprimit të Regjistrimit të Tatimpaguesve”, të cilin BB-ja po realizon në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Administratën Tatimore të Kosovës.

Temë qendrore e takimit me interes për përfaqësuesit e këtij projekti ishte mbledhja e të dhënave dhe informacionit mbi sistemin e administrimit të tatimit në pronë, identifikimi i sfidave dhe mundësive për të përmirësuar sistemin si nga perspektiva e politikave ashtu edhe nga ajo e zbatimit dhe diskutimi i ideve fillestare mbi rekomandimet dhe hapat e mëtejshëm. Agjencia Kadastrale e Kosovës në anën tjetër shprehu gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar në kuadër të këtij projekti me interes të veçantë për qytetarët e Republikës së Kosovës, sidomos në çështjet që ndërlidhen direkt me vlerësimin e pronës.



17.35 (7 Dhjetor) AKK pret në takim përfaqësues nga shoqata e Bankave të Kosovës

Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti me bashkëpunëtorë priti në takim përfaqësues nga Komiteti ligjor i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Në takim u diskutuan mundësitë e avancimeve në regjistrimin e hipotekave në Regjistrin e të drejtave pronësore.

AKK-ja ka implementuar me sukses regjistrimin online të hipotekave tash e 4 vite duke lehtësuar në masë të madhe regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e tyre. Shoqata e bankave vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm me AKK-në duke premtuar vazhdimin e tij më intenziv edhe në të ardhmen.



A hand is holding a white card with the text "PLAN 2024" printed on it. The card is positioned over a dark laptop keyboard. In the bottom left corner, there is a semi-transparent graphic of a bar chart with three bars of increasing height and an upward-pointing arrow. The background is a dark, textured surface, possibly a desk or a book cover.



PLAN 2024

18

PLANI I PUNËS
PËR VITIN 2024 - REFORMAT
DHE PROJEKTET

Nr.	Lista e akteve nënligjore që dalin nga Ligji nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme
1.	Rregullore për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKK dhe ZKK
2.	Hartimi i Strategjis dhe Plani i Veprimit për implementimin e Ligji nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme
3.	Udhëzimi Administrativ për procedurat e punës së komisionit për shqyrtimin e kërkesave për zyrtarizmin e gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP
4.	Udhëzimi Administrativ për procedurat e punës së komisionit për shqyrtimin e kërkesave për plotësimin ose korigjimin e të dhënave në kadastër
5.	Udhëzimi Administrativ për procedurat e punës së nën komisionit
6.	Udhëzimi administrativ për procedurën e rindërtimit të kadastrit dhe regjistrin të të drejtave mbi pronën e paluajtshme
7.	Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e të dhënave dhe mënyrën e krijimit të njësive kadastrale
8.	Udhëzimi Administrativ për formatin dhe procedurën e caktimit dhe rri-rregullimin e kufirit të njësive kadastrale
9.	Udhëzimi Administrativ për procedurat e regjistrimit, modifikimit, dhe fshirjes së barrëve dhe ndalesave
10.	Udhëzimi administrativ për përmbajtjen dhe procedurat e ndarjes dhe bashkimit të zonave kadastrale
11.	Udhëzimi Administrativ për procedurën, kushtet dhe kriteret e licencimit të kompanisë gjeodezike dhe gjeodetit, si dhe punën e Komisionit për Licencim
12.	Udhëzimi administrativ për përcaktimin e procedurës, kushteve dhe kriterëve për certifikimin të personave zyrtar
13.	Udhëzimi Administrativ për tarifën e produkteve, shërbimeve kadastrale, gjeodezik dhe të regjistrimit të pronave në RDPP
14.	Udhëzimi Administrativ për procedurën e kryerjes së matjeve kadastrale dhe gjeodezike, si dhe tarifën për kryerjen e punëve të terrenit
15.	Udhëzimi Administrativ për standardin e zhvillimit, mirëmbajtjes së rretave, matjeve shtetërore, matjeve kadastrale, formën dhe madhësinë e shenjave kufitare dhe pikave gjeodezike
16.	Udhëzimi Administrativ për mënyrën e ndërveprimit të sistemeve dhe përdoruesve të jashtëm me sistemet e informacioneve kadastrale

Nr.	Aktivitetet kryesore	Periudha Kohore
1.	Korrektimi i të dhënave në SIKTK	2024-2025
2.	Rindërtimi i Kadastrit, rreth 140 Zona Kadastrale	2024 - 2026
3.	Kontrolli i Kualitetit për projektin e Rindërtimit të Kadastrit	2024 - 2026
4.	Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik	2024 - 2025
5.	Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave grafike në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit të Ndërtesave	2024 - 2025
6.	Skanimi i Dokumenteve Arkivore Kadastrale	2024 - 2025
7.	Renovimi i Zyreve Kadastrale Komunale në Komunitet Veriore të Republikës së Kosovës	2024
8.	Regjistrimi i ndërtesave dhe banesave në Komunitet Veriore të Republikës së Kosovës	2024
9.	Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës	2024
10.	Zgjerimi i qendrës së të dhënave të AKK-së (Hardware+Software)	2024
11.	Prodhimi dhe instalimi i tabelave të rrugëve dhe numrave të hyrjeve të objekteve	2024
12.	Finalizimi i sistemit të adresave në Komunitet Veriore	2024 - 2025
13.	Lidhja e sistemit të adresave me regjistrin civil	2024 - 2025
14.	Zhvillimi i mobil aplikacionit/navigacionit për Kosovë (ARIS Mobile)	2024 - 2025
15.	Zhvillimi i gjeoportalit për IKIH dhe gjeoportalit shtetëror	2024 - 2025
16.	Avancimi i Sistemeve Kadastrale	2024 - 2025
17.	Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive	2023-2024
18.	Ngritja 3D e objekteve	2024-2025
19.	Analizimi, korigjimi dhe futja në sistemin zyrtar kadastral të elaboreve të shpronësimit	2024-2025
20.	Mirëmbajtja e sistemit të informacioneve kadastrale të tokave të Kosovës	2023-2024
21.	Korigjimi/unifikimi i emërtimeve të personave juridik	2023-2024



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Rr. "Arbënor dhe Astrit Dehari" Nr. 25
Ndërtesa e Arkivit / Kati II
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës